USHTRIA

Viti i 68-të i botimit Nr. 20 (8221) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 23 maj 2014

MAT 5/ AFGANISTAN

Gjenerali Erhan Uzun vlerëson profesionalizmin e ushtarakëve shqiptarë

Komandanti i RCC gjeneral brigade Uzun, viziton ekipin MAT 5

faqe 3

FORCA AJRORE

Zhvillohet takimi i Komitetit të Pilotimit Shqipëri-Francë

faqe 7

BASHKËPUNIMI

Turqia ofron për FA asistencë logjistike dhe trajnime afatgjata

faqe 7

CEREMONIA

Qendra e Trajnimeve të AIM, merr emrin "Shawn Pine"

I jepet medalja "Për shërbime të shquara" (pas vdekjes) nënkolonelit amerikan Shawn Pine

faqe 3

PASTËRTI QË MATET ME KILOMETRA...

Ministria e Mbrojtjes dhe FA marrin pjesë në aksionin e pastrimit të bregdetit

Ministria e Mbrojtjes dhe FA iu bashkuan aksionit të pastrimit me moton "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë pastër"

Faqe 3

Gjeneralmajor Bazo, merr pjesë në takimin e 171-të të shefave të Mbrojtjes së NATO-s dhe atyre partnere

Aleanca, modernizim konkret për përballimin e sfidave të reja

Knud Bartels: NATO duhet të garantojë që ajo ruan aftësinë dhe besueshmërinë për të shpërndarë tre detyrat e saj kryesore, të Mbrojtjes Kolektive, Menaxhimit të Krizave dhe Sigurisë Bashkëpunuese

Faqe 2

INTELIGJENCA

Nevoja për kapacitete ISR në Shqipëri



Funksionet ISR janë elemente parësore të kapaciteteve mbrojtëse të një vendi dhe ato mund të përfshijnë një mori sistemesh kërkimi dhe përpunimi të informacionit që u nevojitet vendim-marrësve të sigurisë kombëtare dhe komandantëve. ISR është përdorur nga ajri që në kohën e Revolucionit Francez ku...

faqe 8-9

KONFERENCA

NATO bazohet tek solidariteti: Të gjithë për një dhe jo një për të gjithë

faqe 4

VIZITA

Një grup gazetarësh dhe reporterësh të huaj vizitojnë anijet e FD

faqe 6

KULTURË

"Dita Ndërkombëtare e Muzeve", në axhendën e muzeut të FA

faqe 13

FORCA DETARE

Roja Bregdetare, operacione të suksesshme ndalim-shoqërimi për tre anije

faqe 6

Gjeneralmajor Bazo, merr pjesë në takimin e 171-të të shefave të Mbrojtjes së vendeve të NATO-s dhe atyre partnere

Objektivi i Aleancës, modernizim konkret për përballimin e sfidave të reja

Knud Bartels: NATO duhet të garantojë që ajo ruan aftësinë, përkushtimin dhe besueshmërinë për të shpërndarë tre detyrat e saj kryesore të Mbrojtjes Kolektive, Menaxhimit të Krizave dhe Sigurisë Bashkëpunuese

Ka përfunduar dje takimi i 171 i shefave të Mbrojtjes së vendeve të NATO dhe atyre partnere, zhvilluar në selinë e NATO në Bruksel. Takimi i dytë për këtë vit, mblodhi sërish së bashku 28 ushtarakët më të lartë të vendeve anëtare të NATO, si dhe komandantët e komandave kryesore të Aleancës. Takimi dy ditor u drejtua nga gjeneral Knud Bartels, kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO dhe solli në qendër të vëmendjes sfidat kryesore më të cilat përballet Aleanca e Atlantikut të Veriut e që i paraprijnë zhvillimit të samitit të radhës së NATO, që do të zhvillohet në Wells, Britani e Madhe. Një nga çështjet më të ngutshme që morën parasysh shefat e Mbrojtjes ishte implikimi i veprimeve të Rusisë në Ukrainë dhe përreth saj. Aneksimi i territorit nga ana e Rusisë, në një komb sovran, në kufijtë e NATO-s ka hedhur një hije pasigurie në krahun Lindor të Aleancës dhe ka implikime për rajonin dhe më gjerë. NATO do të vazhdojë të mbështesë deeskalimin dhe zgjidhjen e krizës aktuale Rusi-Ukrainë nëpërmjet një zgjidhjeje politike. Megjithatë, Aleanca do të jetë e vendosur në parandalimin dhe angazhimin për mbrojtjen kolektive të saj. Dërgimi i avionëve shtesë të Aleancës në misionin e Mbikëqyrjes Ajrore të NATO-s në Baltik dhe të një Grupi Detar të Gatishmërisë së NATO-s në Detin Baltik së bashku me përdorimin e aeroplanëve AWACS të NATO-s mbi Rumani e Poloni, nënvizojnë këtë angazhim. Shefat e Mbrojtjes mbajtën gjithashtu takimin e tyre vjetor me partnerin e tyre ukrainas. Kriza aktuale ishte në qendër të diskutimeve, së bashku me një përmbledhje të mbështetjes së vazhdueshme të NATO-s rreth aktiviteteve të Ukrainës në reformat e mbrojtjes.

Përsa i përket Afganistanit, shefat e Mbrojtjes të NATO-s dhe vendeve partnere shqyrtuan situatën aktuale të sigurisë nën dritën e raundit të fundit së zgjedhjeve presidenciale dhe krahinore. Në këtë vit përfundimtar të operacionit së ISAF-it, ne do të përfundojmë procesin e tranzicionit së rolit të ardhshëm të NATO-s për trajnimin, këshillimin dhe asistencën që nënvizon angazhimin e Aleancës në Afganistan përtej vitit 2014. Populli afgan dhe sidomos Forcat Kombëtare të Sigurisë Afgane, të mbështetur nga NATO dhe partnerët e saj, mund të jenë me të vërtetë krenarë për çfarë kanë arritur dhe do të vazhdojnë të ofrojnë përmes këmbënguljes dhe sakrificës së tyre. Vendi ka ndryshuar në shumë mënyra gjatë 12 viteve të fundit dhe zgjedhjet e fundit të suksesshme reflektojnë këtë moment pozitiv dhe dëshirën e popullit afgan për të formësuar të ardhmen e vendit të tyre. NATO dhe partnerët e saj mbeten të angazhuar në mbështetjen e zhvillimit pa ndërprerje të Forcave të Sigurisë Kombëtare Afgane përtej vitit 2014, përmes një misioni të ri të udhëhequr nga NATO, i quajtur "RESOLUTE SUPPORT" (Mbështetja e Vendosur). Planifikimi për këtë mision vazhdon, megjithatë ai do të zbatohet vetëm kur korniza e nevojshme ligjore të jetë në vend. Ky është një proces i cili tani duhet të përfundojë si një çështje urgjente. Përfundimi i operacionit ISAF të NATO-s këtë vit, do të sjellë me vete një pikë të mundshme ndryshimi strategjik dhe mundësinë e kapacitetin e Aleancës për të ri-fokusuar aftësinë e saj ushtarake ndaj një game më të gjerë kërcënimesh së mundshme të së ardhmes. Siç kemi parë muajt e fundit, situata e sigurisë globale mbetet e brishtë dhe e paparashikueshme dhe Aleanca është gjithnjë e rrethuar nga një hark jo-stabiliteti nga Ukraina në Siria e deri në Sahel. NATO duhet të garantojë që ajo ruan aftësinë, përkushtimin dhe besueshmërinë për të shpërndarë tre detyrat e saj kryesore të Mbrojtjes Kolektive, Menaxhimit të Krizave dhe Sigurisë Bashkëpunuese. Për të arritur këtë qëllim, Aleanca duhet të ndërtojë mbi përvojën, ndërveprimin dhe partneritetet që ajo ka fituar në Afganistan. Kolektivisht dhe individualisht, kombet e NATO-s duhet të investojnë në aftësitë dhe trajnimin e duhur për të zhvilluar gatishmërinë e Aleancës si dhe për të ruajtur avantazhin e saj kryesor, që është parandalimi i saj më i madh ndaj kundërshtarëve të mundshëm. Iniciativa e Forcave të Ndërlidhura dhe Mbrojtja e Zgjuar janë thelbësore në këtë proces transformimi dhe në përpjekjet tona për të vendosur kushtet për forcat e NATO-s 2020, të cilat janë forca moderne, të ndërlidhura mirë, të pajisura, të trajnuara, të stërvitura dhe të komanduara në mënyrë që të bashkëveprojnë së bashku dhe me partnerët në çdo mjedis".

Alba Musaraj,
burimi: NATO.int

STAFI

Kryeredaktor: Albert **HITOALIAJ**

Gazetarë: Mimoza **GOLIKJA**, Alba **MUSARAJ**

Redaktore korrektore: Elona **SHIMAJ MAKO**

Graphic Designer: Afërdita **HYSAJ**

ADRESA: **Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës**

Ministria e Mbrojtjes dhe FA marrin pjesë në aksionin e pastrimit të bregdetit

Pastërti që matet me kilometra...

Në kuadër të aksionit të pastrimit të territorit, me kërkesë të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Mbrojtjes dhe FA iu bashkuan aksionit të pastrimit me moton "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë pastër". Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, e shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe nga kreu i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, z. Auron Tare, ditën e shtunë, në datën 17 maj 2014, inspektuan punën e Forcave të Armatosura në plazhin e Velipojës dhe Shëngjinit. Si rezultat i javës së parë të këtij aksioni në Shëngjin u pastruan 2,2 km, u angazhuan 80 persona dhe 4 mjete; në Velipojë u pastruan 4,5 km, u angazhuan 150 persona dhe 9 mjete; në plazhin Rëra e Hedhur në Shëngjin, u pastruan 3,2 km, u angazhuan 100 persona dhe 5 mjete; në plazhin e Patokut u pastruan 4,9 km, u angazhuan 100 persona dhe 5 mjete; në plazhin e Currilave në Durrës u pastruan 18 km, u angazhuan 50 persona dhe 3 mjete; në Porto-Romano u pastruan 3,2 km, u angazhuan 100 persona dhe 4 mjete; në plazhin e Durrësit u pastruan 3,2 km, u angazhuan 100 persona dhe 5 mjete; në plazhin e Spillesë u pastruan 2,6 km, u angazhuan 50 vetë dhe 4 mjete; në gjirin e Lalzit u pastruan 6,6 km, u angazhuan 150 vetë dhe 9 mjete; në Golem u pastruan 6,4 km, u angazhuan 150 persona dhe 9 mjete; në plazhin e Divjakës u pastruan 3,4 km, u angazhuan 100 persona dhe 6 mjete; në Seman u pastruan 5,6 km, u angazhuan 150 vetë dhe 9 mjete; tek Shkëmbi i Kavajës u pastruan 2,5 km, u angazhuan 100 persona, 5 mjete. Në total në këtë operacion u angazhuan mbi 1380 trupa dhe mbi 79 mjete të Forcave të Armatosura

MAT 5, gjenerali Erhan Uzun vlerëson profesionalizmin e shqiptarëve

Më datë 14 maj 2014, komandanti i Komandës Rajonale të Kryeqytetit (RCC) gjeneral brigade Erhan Uzun, zhvilloi një vizitë në Qendrën Operacionale Taktike (TOC) të ekipit MAT-5 për tu njohur më nga afër me punën e deritanishme të kryer nga personeli i këtij kontingjenti. Ai u prit nga komandanti i MAT-5, kolonel Ardian Bali. Pasi i uroi mirëseardhjen, kol. Bali, fillimisht prezantoi personelin e MAT-5 si dhe e njohu komandantin e RCC me misionin e ekipit, detyrat e realizuara deri tani si dhe marrëdhëniet me homologët afganë. Gjithashtu u diskutua edhe për problemet e sigurisë në zonën e operacionit. Komandanti i RCC duke falënderuar komandantin e kontingjentit MAT-5 për informacionin e dhënë, vlerësoi profesionalizmin e treguar të personelit në punën e kryer deri tani. Para largimit nga TOC, gjeneral brigade Erhan Uzun iu dhurua një dhuratë simbolike si dhe u bë një foto e përbashkët me ekipin. Gjithashtu po më datë 14 maj 2014, komandanti i "task force" "Volunteer", kolonel Randall V. Simmons, kreu një inspektim në Qendrën Operacionale Taktike të kontingjentit MAT-5. Nëpërmjet një prezantimi të shkurtër, kolonel Simmons u njoh me detyrat e kryera deri tani nga personeli i ekipit MAT-5 në interes të këshillimit të shtabit të Brigadës së 1-rë MSF, masat e marra për këshillimin e shtabit të b6 të kësaj brigade si dhe koordinimin me strukturat e tjera për sigurinë e personelit gjatë kryerjes së detyrave në kampin "Warehouse". Gjatë takimit u kërkua informacion nëse kanë filluar përgatitjet për kontingjentin e radhës si dhe për masat e marra për zhvendosjen e ekipit pas mbylljes së bazës "Phoenix". Kolonel Simmons falënderoi për informacionin e marrë, vlerësoi punën e bërë dhe uroi suksese në punën e mëtejshme ekipit MAT-5.

Qendra e Trajnimeve të AIM, merr emrin "Shawn Pine"

Zhvillohet ceremonia e dhënies së medaljes "Për shërbime të shquara" (pas vdekjes) për nënkolonelin amerikan Shawn Pine

Në ambientet e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes (AIM) u zhvillua në datën 19 maj 2014, ceremonia e dhënies së medaljes "Për shërbime të shquara" (pas vdekjes) për nënkolonel Shawn Pine, si dhe dhënies së emrit të tij Qendrës së Trajnimeve të AIM. Në ceremoni ishin të pranishëm ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, gjeneralë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të FA, atasheu ushtarak amerikan, kapiten i rangut të II-të Ralph Shield, etj. Ceremoninë e hapi drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes, gjeneral brigade Ylber Dogjani. Ceremonia është përshëndetur edhe nga atasheu ushtarak i SHBA në Tiranë, kapiten i rangut të II-të Ralph Shield. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli i ka dorëzuar atasheut ushtarak amerikan medaljen "Për shërbime të shquara" (pas vdekjes), akorduar për nënkolonel Shawn Pine. Më pas, ministrja Kodheli me kapitenin e rangut të II-të, Shield, zbuluan pllakën dekorative me emrin dhe foton e nënkolonel Shawn Pine. Më pas, ministrja Kodheli, gjeneralmajor Bazo dhe të pranishmit e tjerë vizituan ambientet e Qendrës së Trajnimeve të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes (AIM), që tashmë mban emrin e nënkolonelit amerikan Shawn Pine. Në kuadër të marrëdhënieve të partneritetit strategjik midis Ministrisë së Mbrojtjes së RSH dhe Departamentit të Mbrojtjes të SHBA, nënkolonel Shawn Pine ushtroi veprimtarinë e tij në periudhën 2004-2005, për reformimin e Shërbimit Informativ Ushtarak (sot Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes). Veprimtaria e nënkolonel Shawn Pine, si përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Inteligjencës të USA (DIA), vlerësohet e shkëlqyer, sepse ai u angazhua drejtpërdrejtë në ndërtimin institucional të SHIU mbi bazën e standardeve të agjencisë së inteligjencës të SHBA, duke dhënë një kontribut të pashlyeshëm në transformimin që pësuan agjencitë e inteligjencës në vendin tonë në kushtet e shtetit demokratik, si dhe u angazhua në mënyrë të drejtpërdrejtë në punën praktike që u duket të bëjnë ekspertët dhe specialistët e këtyre agjencive.

Fillon kampionati i futbollit i Forcave të Armatosura

Ka filluar ditën e hënë, më datë 19 maj 2014, në ambientet sportive të Ministrisë së Mbrojtjes, kampionati i futbollit ndërmjet strukturave ushtarake. Në të janë përfshirë tetë ekipet e futbollit nga Forca Tokësore, Forca Ajrore, Forca Detare, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, Brigada Logjistike, Brigada e Mbështetjes Rajonale, Policia Ushtarake dhe Regjimenti i Mbështetjes së SHPFA. Kampionati nisi me një demonstrim nga ana e ekipit të karatesë së fëmijëve të ushtarakëve, për të vazhduar me ndeshjen e parë midis ekipit të Forcës Detare dhe ekipit të Komandës së Doktrinës. Në këtë kampionat janë aktivizuar mbi 100 futbollistë që të gjithë efektivë ushtarakë dhe civilë të Forcave tona të Armatosura. Në ceremoninë e hapjes së këtij aktiviteti sportive merrnin pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, kryetari i Komitetit Olimpik Shqiptar, z. Viron Bezhani, komandantët e forcave, gjeneralë, ushtarakë, etj.

Bashkëpunimi

Reagimi i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s në raport me lëvizjet e trupave ruse

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, bëri këtë koment, para shtypit, në Mal të Zi, më 22 maj, në lidhje me raportet e lëvizjes së trupave ruse: "Dje vonë, ne pamë aktivitetin e kufizuar të trupave ruse në afërsi të kufirit me Ukrainën, që mund të sugjerojë se disa nga këto forca po përgatiten të tërhiqen. Është shumë shpejt të thuhet se çfarë do të thotë kjo, por unë shpresoj se ky është fillimi i një tërheqjeje të shpejtë e të vërtetë.

Aktualisht, shumica e forcave ruse të dislokuara më parë mbetet në afërsi të kufirit të Ukrainës dhe ne shohim stërvitje të vazhdueshme ruse në të njëjtën zonë. Nëse ne shohim ndonjë tërheqje kuptimplotë e të verifikueshme, unë do të jem i pari që do e mirëpres atë. Ky do të ishte hapi i parë nga ana e Rusisë në drejtimin e duhur për të përmbushur angazhimet e saj ndërkombëtare, veçanërisht tani që Ukraina po përgatitet të mbajë zgjedhjet e saj të rëndësishme presidenciale ditën e dielë, më 25 maj. Unë shpresoj që ne të shohim një zgjidhje politike dhe diplomatike për krizën ukrainase".

KONFERENCË MUJORE PËR SHTYP

NATO bazohet tek solidariteti: Të gjithë për një dhe jo një për të gjithë

ANDERS FOGH RASMUSSEN

Gjatë javëve të fundit, kam vizituar shumë nga aleatët tanë në Europën Qendrore dhe Lindore. Këtë vit, ata shënuan përvjetorë të rëndësishëm së pranimit të tyre në NATO. Së bashku, ne kemi bërë një rrugë të gjatë drejt qëllimit tonë: Një Europë e tërë, e lirë dhe në paqe, por sot është e qartë se ne nuk mund ta marrim si të mirëqenë atë që kemi arritur. Kjo sepse agresioni i Rusisë kundrejt Ukrainës ka paraqitur një sfidë për parimin themelor: Të drejtën e shteteve sovrane për të zgjedhur rrugën e tyre. Rusia është angazhuar për këtë rregull shumë herë, por po shohim se presidenti Putin tani nuk pranon ta mbështesë këtë premtim.

Më 25 maj, Ukraina do të mbajë zgjedhjet presidenciale. Kjo është një mundësi e rëndësishme për të gjetur një rrugë paqësore drejt një Ukraine të bashkuar. Kjo ka të bëjë me njerëzit në të gjithë vendin, pa marrë parasysh gjuhën që ata flasin, kanë mundësi të bëjnë zgjedhjen e tyre të lirë e demokratike, në përputhje me ligjin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare. Kjo është vota që ka rëndësi për Ukrainën dhe për komunitetin ndërkombëtar. Çdo përpjekje për të vonuar apo për të prishur zgjedhjet, do të ishte një përpjekje për t'i mohuar popullit ukrainas të drejtën e zgjedhjes së tyre si dhe një hap mbrapa për përpjekjet për të gjetur një zgjidhje të mirëfilltë politike së krizës. Tashmë, ne kemi marrë masa të menjëhershme: Më shumë avionë në ajër, më shumë anije në det dhe më shumë stërvitje në terren. Ne kemi vendosur avionë të mbikëqyrjes AWACS mbi Poloni dhe Rumani dhe kemi përforcuar misionin tonë të mbikëqyrjes ajrore në rajonin e Baltikut. Unë i kam parë në veprim dhe ata po bëjnë një punë të shquar. Aleatët kanë përforcuar praninë tonë detare nga Baltiku në Detin e Zi si dhe kanë vendosur trupa për të marrë pjesë në trajnime dhe stërvitje.

Trupa nga e gjithë NATO po marrin pjesë në stërvitjen "Steadfast Javelin", e cila po zhvillohet në Estoni. Kjo është një stërvitje e rëndësishme, që teston aftësinë tonë për të sprapsur një sulm kundër një aleati. Kjo stërvitje ishte parashikuar shumë kohë para krizës, por është një shembull i mirë i hapave që janë ndërmarrë për të përkrahur forcat tona dhe gatishmërinë e tyre. Më lejoni të theksoj: Të gjitha këto masa janë krejtësisht mbrojtëse dhe tërësisht në përputhje me angazhimet e NATO-s.

Ne do të vazhdojmë të bëjmë çfarë është e nevojshme dhe për sa kohë të jetë e tillë. Në fillim të qershorit, ministrat e Mbrojtjes së NATO-s do të takohen në Bruksel për t'i hapur rrugën samitit tonë të Uellsit së muajit shtator. Ne do të diskutojmë hapat e mëtejshëm për të përforcuar mbrojtjen tonë kolektive. Angazhimi ynë për të mbrojtur aleatët tanë është i fortë si shkëmb. Pra, ne po kërkojmë të forcojmë aftësinë tonë për të reaguar shpejt ndaj çdo lloj kërcënimi, duke përfshirë dhe ato ku kemi një paralajmërim të vogël. Ne po rishikojmë dhe përditësojmë planet tona të mbrojtjes për të marrë në konsideratë një mjedis më të paparashikueshëm sigurie. Gjithashtu, ne po marrim parasysh se si mund të ndërtojmë mbi Iniciativën e Forcave tona të Ndërlidhura, për t'i bërë stërvitjet tona më të shpeshta dhe më të kërkuara. Ne duhet të shfrytëzojmë çdo skenar, duke përfshirë edhe mbrojtjen kolektive dhe duhet të përsërisim përforcimin.

Për t'i bërë të besueshme mbrojtjen dhe parandalimin, kemi nevojë për aftësi të besueshme. Sigurisht, aftësitë kushtojnë, por siguria jonë është themeli i prosperitetit tonë. Pra, ne duhet të vazhdojmë të kontrollojmë se sa kemi shpenzuar në mbrojtje dhe si e kemi shpenzuar atë. Ky është një proces i vazhdueshëm dhe po shohim përpjekje inkurajuese për të filluar përmbysjen e tendencës në rënie të së buxheteve të mbrojtjes dhe shohim bashkëpunim më të madh shumëkombësh. Kjo nuk është e lehtë, por më shumë se kurrë kjo është jetike. NATO bazohet tek solidariteti: Të gjithë për një dhe jo një për të gjithë. NATO e mban të sigurt çdo aleat dhe çdo aleat duhet të luajë rolin e tij të plotë për të kontribuar në sigurinë tonë të përbashkët".

Zhvillohet stërvitja "Steadfast Javelin 1" në Estoni

NATO filloi një stërvitje të një shkalle të gjerë "Steadfast Javelin 1" në Estoni më 16 maj, e cila do të testojë forcat e aleatëve mbi aftësinë e tyre për të punuar së bashku si dhe për të ruajtur efektivitetin luftues dhe gatishmërinë e NATO-s. "Stërvitja "Steadfast Javelin 1" reflekton angazhimin e fortë të NATO-s në mbrojtjen kolektive në rajonin e Baltikut", tha komandanti i Forcave te Përbashkëta Aleate Brunssum, gjenerali Hans-Lothar Domröse. "Është privilegj i madh që marr komandën e forcave që marrin pjesë në këtë stërvitje. Nuk ka dyshim që Aleanca është e fortë dhe vendosmëria e NATO-s për të siguruar anëtarët e saj mbi dobinë e vazhdueshme të Traktatit

të Uashingtonit mbetet thelbësore për veprimet tona". Rreth 6.000 trupa nga Belgjika, Danimarka, Estonia, Franca, Lituania, Letonia, Polonia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, po marrin pjesë në stërvitjen e cila do zgjati deri më 23 maj. Stërvitja është bazuar në një skenar fiktiv dhe përfshin forcat pjesëmarrëse aleate që zmbrapsin një sulm mbi Estoninë. Pjesëmarrësit ishin gati në Estoni që më 5 maj, duke marrë pjesë në stërvitjen vjetore "Kevadtorm 14", të udhëhequr nga Estonia, e cila tashmë është bashkuar me ngjarjen e udhëhequr nga NATO. Njësitë pjesëmarrëse përfshijnë këmbësorinë dhe zbuluese, inxhinierë, avionë luftarakë si dhe ekipet anti-ajrorë dhe një ekip të sigurisë kibernetike. Këshilli i Atlantikut të Veriut ra dakord më 16 prill për një paketë shtesë masash ushtarake për të përforcuar mbrojtjen kolektive të Aleancës në prag të krizës në Ukrainë. Këto masa përfshijnë stërvitje të zgjeruara, planet e përditësuara të mbrojtjes dhe dislokimet e duhura.

Alba Musaraj,
burimi: NATO.int

FT, angazhim i fuqishëm për pastrimin e plazheve

Forca Tokësore në ditën e parë të operacionit për pastrimin e plazheve me datë 17 maj 2014, u angazhua me 700 trupa dhe 40 automjete. U pastruan gjithsej 26.9 km bregdet dhe u hoqën 228 m3 mbetje në plazhet Velipojë, Gjiri i Lalzit, plazhi i Golemit, plazhi i Divjakës dhe plazhi i Semanit.

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, e shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku dhe Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, z. Auron Tare inspektuan punën e Forcave të Armatosura, struktura të FT-së në plazhin e Velipojës. Ministrja Kodheli përgëzoi efektivat për punën e bërë. Sikurse shprehet komandanti i batalionit nënkolonel Nikolin Lazri, para fillimit të aksionit zhvilluam dy ditë më parë përnjohjen në zonën tonë të përgjegjësisë, ku kontaktuam me Kryetarin e Komunës Velipojë zoti Pashk Ujka dhe përfaqësues të tjerë të pushtetit vendor në zonën Velipojë, të cilët ju bashkëngjitën aksionit për pastrimin e plazhit. Nga ana e përfaqësuesve të pushtetit u vlerësua puna e bërë nga strukturat e Forcave të Armatosura, të cilët shprehen, se iniciativa të tilla për mirëmbajtje të mjedisit kërkojnë më tepër angazhim dhe ndërgjegjësim të komunitetit e sidomos të biznesmenëve që ushtrojnë aktivitetin pranë këtyre plazheve. Nga efektivat e batalionit të parë, edhe pse koha ishte me shi u pastrua një distancë plazhi prej 4.5 km dhe u grumbulluan dhe u transportuan rreth 35 m 3 ton mbetje të ndryshme.

Strukturat e Forcës Tokësore u angazhuan edhe Plazhin Gjiri i Lalsit me efektivat e batalionit të dytë të këmbësorisë. Z.Fatos Bundo, inxhinier dhe specialist pranë Agjensisë Kombëtare të Bregdetit, i cili ndoqi nga afër punën e kryer nga këto struktura, theksoi se puna e bërë nga efektivat e ushtrisë është e vlerësueshme, kjo falë bashkëpunimit të siguruar më parë midis drejtuesve të ushtrisë, pushtetit vendor dhe Agjensisë Kombëtare të Bregdetit, e cila ka përfaqësuesit e saj pranë zonës së plazhit. Ai shprehet se nuk mund të lë pa përmendur përkushtimin e efektivave, pjesëmarrëse në operacion, të cilët megjithëse nuk i favorizoi koha, me shi , përsëri në saj edhe të bashkëpunimit me drejtuesit e batalionit të dytë u bë e mundur që me 150 trupat dhe 9 mjete e angazhuara dhe 9 mjetet të pastrohet një territor prej 6,6 km i gjatë. Në ndihmë të këtij batalioni kishin ardhur edhe disa mjete transporti dhe fadroma për heqjen e mbetjeve dhe transportimin e tyre të Brigadës së Mbështetjes rajonale. Batalioni Komando me 150 trupa dhe 9 mjete u angazhuan në mbështetje të prefekturës Durrës në Plazhin e Golemit. U pastruan rreth 6.4 km gjatësi. Batalioni i Forcave Speciale u angazhuan në pastrimin e plazhit të Divjakës me 100 forca dhe 6 mjete, i cili pastroi rreth 4.1 km. Kolonel Dilaver

Hoxha zv/komandanti i FT, me disa anëtarë të shtabit ka ndjekur në vijimësi operacionin nga plazhi i Velipojës deri në gjirin e Lalëzit, Durrës. Në mbështetje të qarkut të Fierit u angazhuan 150 forca dhe 9 mjete të batalionit të tretë të këmbësorisë, Poshnje Berat. Komandanti i këtij batalioni nënkolonel Gëzim Marku, shprehet se në këtë operacion në krahasim me operacionet që kemi kryer më parë, shikojmë një bashkëpunim më të mirë me strukturat e pushtetit vendor. Nga ana jonë u morën të gjitha masat për realizimin e detyrës. Për këtë kemi vendosur pika kontakti me të gjitha strukturat e pushtetit vendor dhe strukturat e tjera mbështetëse që veprojnë në këtë qark. Aktualisht po punojmë me strukturat e pushtetit vendor në rrethin e Sarandës për të koordinuar punën me këto strukturat për javën e dytë të këtij aksioni. Do të theksoja se mbajtja pastër e plazhit është detyrë e gjithkujt dhe gjykoj se më shumë duhet bërë nga pushteti vendor dhe komuniteti i zonës. Shefi i shtabit të FT, kolonel Adi Ndoni së bashku me kryetarin e komunës Seman, kanë ndjekur gjatë gjithë ditës ecurinë e punës dhe në përfundim kanë falenderuar efktivat e këtij batalioni. Operacioni për pastrimin e plazheve nga strukturat e FT-së do të vijojë me datë 24 maj në plazhin e Shirokës, Vlorës, Rradhimës, Orikumit dhe Palasë. Për këtë thotë shefi i Degës së Bashkëpunimit Civilo- Ushtarak, Nënkolonel Shpëtim Hysa, kemi vendosur pikat e kontaktit me strukturat e pushtetit vendor dhe bashkërendojmë për këtë qëllim punën me drejtuesit e reparteve të FT-së, që do të angazhohen në këtë operacion.

Major Nexhbedin Basha

ASNI, pjesëmarrje aktive në pastrimin e vijës bregdetare

Në kuadër të aksionit kombëtar, për pastrimin e mbetjeve inerte dhe papastërtive në vijën bregdetare, ditën e shtunë me dt 16.08.2014, trupat e Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, u përqendruan në bregdetin e Durrësit. Forcat e ASNI-së, morën pjesë në këtë aksion me një grup prej 50 vetash, të mbështetura me një fadromë dhe dy kamionë "Astra", të ardhura nga Brigada e Mbështetjes Rajonale. Operacioni i detajuar më së miri, para se të merrte rrugë ne terren, kaloi në një punë parapërgatitore dhe angazhim tepër serioz nga i gjithë Shtabi i Agjencisë, i drejtuar nga n/kolonel Emin Koltraka dhe shefi i Operacioneve major Artur Beqiri, në ambientet e Qendrës Operacionale të ASNI-së. Masat e marra nga Shtabi i ASNI-së, përfshinin jo vetëm procesin rutinë të përgatitjes së planit, ndarjes së forcave dhe mbështetjen logjistike, por një rëndësi e veçantë, iu kushtua koordinimit të punës në terren me përfaqësuesit e pushtetit lokal, si dhe të Agjencisë së Bregdetit, ku përfaqësuesja e kësaj Agjensie znj. Julia Pacani, do të gjendej gjatë gjithë kohës së operacionit në terren, bashkë me trupat e ASNI-së. Në orën 08:30, edhe pse moti nuk ishte i favorshëm, për shkak të reshjeve të dendura të shiut, që përfshinë vendin tonë gjatë gjithë javës, trupat e ASNI-së, filluan punën për pastrimin e vijës bregdetare në zonën e Currilave. Kjo zonë e bukur e bregdetit tonë, pas gati 7 orë pune të pandërprerë nga efektivi i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, do të arrinte "të merrte frymë" sërish, pas heqjes së mbetjeve inerte dhe urbane. Terreni i pastruar nga trupat e ASNI-së, përshiu një gjatësi lineare prej gati 1.8 km. Aksioni në vijën bregdetare i ASNI-së, vjen pas angazhimit dhe kontributit shumë domethënës të kësaj Agjencie, në pastrimin e rrugëve kombëtare jo shumë kohë më parë. Operacioni, për rivitalizimin dhe pastrimin e vijës bregdetare të Currilave, u drejtua nga Komandanti i ASNI-së, n/kolonel Ulsi Rexhaj, i cili në përfundim të tij, përgëzoi dhe falënderoi gjithë trupat pjesëmarrëse për kontributin e tyre.

Kapiten Ervin Hodo

BRIGADA LOGJISTIKE

Forcohen rregullat e sigurisë në Brigadën Logjistike

Prej disa ditësh në këtë njësi nën drejtimin e kolonel Besnik Sylaj zhvillohet një analizë e thellë e tërë punës së këtij viti dhe në mënyrë të veçantë janë forcuar rregullat e sigurisë të disiplinës në punë të uniformës dhe tërë aktivitetit të përditshëm. Në analizat ditore dhe në komunikatat e mëngjesit është diskutuar me përgjegjësi të plotë dhe me analizë të thellë tërë problematika e vitit 2014 dhe njëzëri është krijuar bindja që duhet ndryshim rrënjësor. Mbi të gjitha është kontrolluar dhe vënë në binarët e rregullores rregullat e sigurisë të hyrje-daljes nga reparti, të administrimit të vlerave materiale të inventarizimit të thellë dhe të detajuar të municioneve dhe të lëndëve plasëse dhe në mënyrë të veçantë përgjegjësitë dhe detyrat e secilit komandant të kësaj njësie. Nisur nga kjo analizë e thellë kolonel Besnik Sylaj thotë për gazetën "Ushtria" se: "Në radhë të parë janë vënë pikat mbi 'i' për problemet e disiplinës, për rreshtimin organik, për adresën dhe tërë aktivitetin e detyrave që kryejnë tërë oficerët dhe shtabi i kësaj brigade. Jemi të bindur se ka problem, por kjo nuk mund të eklipsojë punën e shumë ushtarakëve të përgjegjshëm dhe të disiplinuar. Ndaj kemi dhënë detyra shumë precize për tu zbatuar me shumë përgjegjësi dhe korrektësi ku të raportohet për to me detaje. Analiza e thellë ka filluar që në qelizë në vendrojat dhe truprojat poshtë në bazë dhe deri në vend-dislokimin e Brigadës Logjistike. Janë hartuar raporte të sakta ditore dhe kjo punë është në fillimet e saj dhe do të vazhdojë për tu përmirësuar dhe për të zbatuar tërë detyrat që janë në plan kalendarin vjetor. Që në hyrje të reparteve ka ndryshuar gjithçka dhe ky ndryshimin është rrënjësor në tërë dinamikën e punës dhe në tërë vend-shtrirjen e kësaj njësie. Janë vënë para përgjegjësisë tërë shefat e shërbimeve në Shtabin e Brigadës që detyrat t'i kryejnë sipas rregullores së sigurisë dhe sipas rregullores së jetës së përditshme. Po analizohen thellësisht shumë fakte dhe shumë ngjarje të këtij vitit dhe po përcaktohen detyra për vazhdimin, i cili të jetë i një cilësie krejt tjetër dhe puna kryesore të përqendrohet tek figura e ushtarakut, e cila duhet të jetë katërcipërisht rigoroze dhe e qartë në çdo aktivitet të saj." Kjo njësi këto ditë është angazhuar dhe në operacionin për pastrimin e territorit të plazheve. Në Patok u pastrua një vijë bregdetare prej 4.9 kilometrash duke marrë pjesë 100 forca dhe shtatë mjete aksion, i cili do të përsëritet dhe këtë të shtunë në Zvërnec të Vlorës duke marrë pjesë 10 mjete 100 forca dhe do të pastrohet një vijë bregdetare prej rreth 5 kilometrash e cila sipas rikonicionit të djeshëm është e mbushur me mbeturina të nxjerra nga deti. Ky ndryshim rrënjësor sapo ka filluar dhe do të vazhdojë me këtë intensitet.

VIZITA

Një grup gazetarësh dhe reporterësh të huaj vizitojnë anijet e Forcës Detare

Një grup reporterësh dhe gazetarësh të vendeve të ndryshme të Europës, në datën 15 maj 2014, kanë vizituar grupin e anijeve të klasit "Iliria", në portin detar të Durrësit, të shoqëruar nga disa gazetarë vendas. Grupi prej 14 gazetarësh dhe reporterësh nga Italia, Gjermania, Suedia, Çekosllovakia, Maqedonia, etj, u prit nga shefi i Shtabit të Forcës Detare, kapiten i rangut të II-të Adnand Agastra, i cili fillimisht ju uroi mirëseardhjen dhe i informoi shkurtimisht ata për misionin, detyrat që kryejnë anijet e klasit "Iliria", si dhe detyrat që zbatojnë në kuadër të bashkëpunimit me institucionet e tjera me interesa në det. Më pas, kapiten lejtnant Edison Hoxha, komandant i anijes "Iliria", informoi gazetarët mbi detyrat që kryen kjo anije, zgjidhjen e situatave të ndryshme në det, historikun e prodhimit dhe pjesëmarrjen në stërvitje të ndryshme ndërkombëtare. Pastaj, kapiten i rangut i II-të Agastra iu përgjigj shumë pyetjeve të drejtuara nga gazetarët dhe reporterët, që kryesisht u fokusuan mbi përdorimin, procedurat dhe mënyrën e bashkëpunimit në raste emergjencash, SAR, ndërveprimi me Policinë Kufitare, etj. Kapiten lejtnant Hoxha më pas udhëhoqi turin e gazetarëve dhe reporterëve në ambientet e brendshme të anijes, ku u prezantoi ekuipazhin e anijes, ambientet e punës dhe shërbimit, si dhe iu përgjigj pyetjeve teknike mbi procedura të ndryshme gjatë lundrimit.

Roja Bregdetare, operacione të suksesshme ndalim-shoqërimi për tre anije

Tre anije të ndaluara dhe shoqëruara nga anija e Rojës Bregdetare e Forcës Detare P-03 është bilanci i dy ditëve shërbimi si anije e gatshme në Sazan, përkatësisht në datat 16 dhe 17 Maj 2014. Në datë 16.05.2014, ora 09:40, anija P-03 me Komandant Kapiten Lejtnant Elton Demiraj, mori detyrën për ndalim-shoqërim të një mjeti lundrues detar, anije tregtare e cila ndodhej në perëndim të gryk derdhjes së Vjosës. Sipas procedurave standarde të ndalimit, pas imbarkimit të tre oficerëve të Policisë Kufitare, anija mori urdhër për ndalimin dhe bordimin e anijes tregtare e cila ndodhej në koordinata Φ= 40◦ 43',39'' dhe λ=19◦ 12',15''. Në orën 15:00 anija mbërriti në afërsi të mjetit detar i cili ndodhej në koordinata Φ= 40◦ 48',01'' dhe λ=19◦ 06',01''. U realizua ndërlidhja me anijen tregtare dhe u morën të gjitha të dhënat nëpërmjet radios dhe u plotësuan në proces verbalin përkatës. Anija tregtare me emrin "ERA-1", e tonazhit 438 ton, me flamur Tanzanian, port regjistrimi Zanzibar, Tanzani, destinacion Bar, Mali Zi, me ngarkesë 7 ton cigare, me kapiten Vladimir Devagov me nënshtetësi Ukrainas, me 7 pjesëtarë ekuipazhi, me urdhër të QNOD dhe në pamundësi të bordimit të saj si arsye e detit të keq, u shoqërua drejt portit të Durrësit. Rreth orës 19:00 erdhi në rajon edhe anija e gatshme e vendqëndrimit Kepit të Palit dhe mori detyrë shoqërimin e saj drejt portit të Durrësit. Gjithashtu, në orën 15:55 të datës 17 Maj, anijes iu dha kushtrim luftarak nga QNOD për të filluar zbatimin e detyrës së dhënë të ndalim-shoqërim të dy peshkarexhave të cilat ndodheshin në koordinata Φ= 40◦ 34',00'' dhe λ=19◦ 19',03''. Me mbërritjen në vendin ku ndodheshin dy peshkatoret, përkatësisht peshkatorja "Muharrem Rexha" dhe peshkatorja "Ilirjana", me flamuj shqiptarë, u komunikua me ato për shkeljen e kryer, u morën të gjitha të dhënat konform rregullit dhe u bë shoqërimi i tyre drejt portit të Triportit, Vlorë. Aty i priste personeli i Policisë Kufitare nga ku ju dorëzuan të gjitha proces verbalet e mbajtura dhe shkeljet e konstaturara "përdorimi i tratave fundore në thellësi jo të lejuar sipas ligjit".

Pastrohet 2.5 km plazh në rajonin e Shkëmbit të Kavajës

Rreth 10 ton mbeturina u grumbulluan dhe u hoqën nga plazhi i Shkëmbit të Kavajës nga rreth 100 forca ushtarake të Forcës Detare ditën e shtunë, datë 17 maj 2014. Me një plan paraprak të detajuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Forca Detare angazhoi 4 mjete për transportin e mbeturinave për në qendrën e grumbullimit të mbeturinave të qytetit të Durrësit. Aksioni i pastrimit filloi në orën 09:30 deri në orën 17:00 dhe u drejtua nga komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Qemal Shkurti dhe shefi i Shtabit i FD, kapiten i rangut II-të Adnand Agastra.

"Kantieri i Ndërtimit të Anijeve" në përvjetorin e 45-të

Është 20 Maji i vitit 1969 kur filloi si një ofiçinë modeste ku riparoheshin rastet emergjente dhe kryheshin ndërhyrje të thjeshta për anijet e Bazës Ushtarake Detare të Pashalimanit si dhe funksiononte një ofiçinë riparuese për t'u ardhur në ndihmë urgjente nëndetëseve. Më pas, u krijua Kantieri i Remontit të Anijeve Luftarake të Flotës (KRAF). Në vitin 1975, mbërritën specialistët kinezë, për të bërë remontin e mesëm të nëndetëseve. Janë këto disa prej etapave të cilat kujton një detar i vjetër prej këtij kantieri. I vendosur 25 km në jug-perëndim të Vlorës, në vendbazimin e Flotiljes Detare Pashaliman, me rreth 155 punonjës kryesisht civilë, specialistë të mirëfilltë si saldatorë, bojaxhinj, hidraulikë etjer, të drejtuar nga një staf drejtuesish inxhinierë profesionistë dhe me eksperiencë, ky kantier krenohet jo vetëm me historikun e tij të riparimit të anijeve, nëndetëseve ushtarake të klasit dhe tipeve të ndryshme, por në 4 vitet e fundit padyshim krenohet me ndërtimin e anijeve të reja ushtarake patrulluese për Forcën Detare.Janë tashmë 3 anije patrulluese të klasit "ILIRIA STAN PATROL" që ky kantier ka ndërtuar, përkatësisht "Oriku", Lissus" dhe "Butrinti", me parametra të mjeteve moderne bashkëkohore në këtë lloj, me gjatësi dhe gjerësi respektive 42 metra dhe 7 metra si anije të Rojës Bregdetare Shqiptare, për ruajtjen dhe kontrollin e hapësirës bregdetare shqiptare. Anijet e ndërtuara në Kantierin e Ndërtimit të Anijeve (KNA), nën mbikëqyrjen e kompanisë hollandeze "DAMEN Shipyards", janë pjesë e marrëveshjes me një vlerë financiare prej rreth 31 milionë euro, e realizuar me financim të qeverisë shqiptare dhe e mbështetur me një grant prej 35 përqind të kësaj vlere nga qeveria holandeze. Për KNA ndërtimi i anijeve ushtarake ka qenë një sfidë në vetvete që shënon një etapë të shkëlqyer për historikun e kantierit si dhe për momentet dhe vështirësitë e krizës financiare që në tërësi bota po kalon. I përbërë në vetvete nga disa sektorë si Sektori i Planizimit, i Sigurisë dhe Cilësisë, i Teknologjisë, i Ndërtimit të Anijeve, (Saldimit, Montimit, Agregatëve, Tubomekanik, Elektrik/Elektronik, Karpentier/Bojaxhi), i Riparimit të Motorave, i Dokimit etj., krahas teknologjisë moderne të ndërtimit dhe prodhimit të pjesëve kryesore të anijeve, këta sektorë kanë fituar tashmë eksperiencë të sprovuar dhe të konsoliduar dhe të certifikuar nga specialistët e kompanisë holandeze. Krahas përfitimit në teknologji, një vlerë të pallogaritshme ka eksperienca e punonjësve që ka ky kantier. Kështu në planet e së ardhmes, synohet përdorimi i këtij kantieri jo vetëm për qëllime të mirëfillta ushtarake por dhe për riparimin e anijeve të tjera civile të tonazheve të ndryshme.

Komanda e Forcës Ajrore: Zhvillohet takimi i Komitetit të Pilotimit Shqipëri-Francë

Më datë 19 maj 2014, në komandën e Forcës Ajrore u zhvillua takimi i përvitshëm i Komitetit të Pilotimit mes Shqipërisë dhe Francës në kuadrin e marrëveshjes në fushën eaAeromobilitetit. Komiteti i Pilotimit është ngritur dhe funksionon që prej vitit 2012. Ngritja dhe funksionimi i këtij komiteti është vlerësuar si mjaft i rëndësishëm, pasi në të diskutohet për realizimin e projekteve me vlerë për Forcën Ajrore siç janë, marrëveshja dypalëshe e helikopterëve Cougar, trajnimi i pilotëve, procedurat e mirëmbajtjes së këtyre helikopterëve, hartimi i dokumenteve dhe manualeve të shfrytëzimit të helikopterit Cougar, etj. Pala franceze kryesohej nga ambasadorja e Republikës së Francës në Shqipëri znj. Christine Moro dhe shoqërohej nga atasheu i Mbrojtjes i Francës, kolonel Henri Sowa, drejtori i Operacioneve Eksport Helikopterësh në DGA/DI/DE, në Ministrinë e Mbrojtjes së Francës, nënkolonel Benjamin Gailly, piloti-instruktor francez i atashuar në Forcën Ajrore shqiptare, major Thierry Solignac, drejtori i Airbus Helicopters për Europën z. Laurent Visa dhe z. Zalo Koka, POC dhe përkthyes. Fillimisht delegacioni francez u prit në një takim kortezie nga komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Frederik Beltoja dhe me tej u vijua takimi dypalësh në sallën e mbledhjeve të Forcës Ajrore. Takimi u hap me fjalën e komandantit të Forcës Ajrore, ku u bë një përmbledhje e veprimtarisë së Komitetit të Pilotimit, u evidentuan arritjet e deritanishme në fushën e implementimit të projektit të helikopterëve Cougar, në trajnimin e ekuipazheve ajrore dhe të mirëmbajtjes, të dokumentacionit të fluturimit, të standardizimit të programeve të trajnimit, si dhe në punën e bërë për përgatitjen e Rregullores së Fluturimit të Forcës Ajrore. Gjatë zhvillimit të takimit nga pala shqiptare u vlerësua puna e mirë e bërë nga major Thierry Solignac në të gjitha drejtimet si dhe kontributi i dhënë për arritjet e mësipërme. Gjithashtu gjatë takimit u trajtuan edhe problematikat e ndeshura gjatë vitit, si dhe nevojat për të ardhmen. Ndër problemet kryesore aktuale mbetet nevoja për mbështetje me mirëmbajtje dhe garantimi i vazhdimësisë së operacionalitetit të helikopterëve sipas normativave të Sigurisë së Fluturimit. Më tej u vijua me një prezantim të komandantit të Bazës Ajrore Farkë, nënkolonel Altin Lama, për ecurinë e deritanishme të Projektit Cougar dhe bilancin e punës në këtë drejtim, duke u fokusuar tek orët e fluturimit me helikopterët Cougar, trajnimi i pilotëve dhe vazhdimësia e tij, si dhe puna e bërë për mirëmbajtjen e

helikopterëve si dhe trajnimi 'on job training' për specialistët e mirëmbajtjes. Major Thierry Solignac bëri një përmbledhje të detajuar të ecurisë së punës për ekuipazhet ajrore, trajnimin taktiko-operacional, SAR/CSAR, IFR, NVG, dhe përgatitjen për realizimin e një simulimi TACEVAL me synim përgatitjen e 2 ekuipazheve ajrore Cougar për misione në kuadrin e NATO-s deri në vitin 2018. Gjithashtu, u bë prezent puna e bërë edhe për standardizimin e dokumentacionit të fluturimit dhe atij teknik (Manuali i Operimit të Helikopterit Cougar, dhe Rregullorja e Fluturimit të Forcës Ajrore). Në përfundim të takimit ambasadorja e Republikës së Francës znj. Christine Moro, falënderoi Komandën e Forcës Ajrore për pritjen e organizuar, si dhe shprehu vlerësimin maksimal për punën e bërë dhe për bashkëpunimin e treguar nga pala shqiptare. Ajo nënvizoi rëndësinë e implementimit me sukses të projektit Cougar mes dy vendeve, si dhe shprehu gatishmërinë e palës franceze për të vazhduar mbështetjen e palës shqiptare në projektet e mbrojtjes në tërësi dhe atij të helikopterëve në veçanti. Ndërsa komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Frederik Beltoja falënderoi zonjën Ambasadore, Atasheun ushtarak dhe palën franceze në tërësi për mbështetjen dhe predispozicionin e treguar për vijimin e mbështetjes dhe bashkëveprimit në të ardhmen. Forca Ajrore do të vijojë procesin e modernizimit të saj sipas direktivave dhe prioriteteve të mbrojtjes në tërësi, ku projekti Cougar zë vend parësor.

Turqia ofron për FA asistencë logjistike dhe trajnime afatgjata

Një delegacion i Forcave Ajrore turke zhvilloi një vizitë pune në repartet e Forcës Ajrore

Nga data 19 deri në 21 maj 2014, në kuadër të planit të bashkëpunimit dypalësh për vitin 2014 midis Forcës Ajrore Shqiptare dhe Forcave Ajrore Turke, zhvilloi një vizitë pune në repartet e Forcës Ajrore një delegacion turk i përbërë nga kolonel Hakan Dinç dhe major Polat Çevik, të cilët shoqëroheshin nga atasheu i Turqisë në vendin tonë, kolonel Nizamettin Dogar. Qëllimi i zhvillimit të kësaj vizite pune ishte njohja me Forcën Ajrore Shqiptare si dhe prezantimi nga ana e ekipit turk e të gjitha mundësive të trajnimit afatgjatë dhe afatshkurtër si dhe asistencën logjistike që ofron pala turke në interes të Forcës Ajrore Shqiptare. Ditën e parë të vizitës në Shqipëri delegacioni turk u prit në takim nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Mehmet Metko, i cili pasi i falënderoi për vizitën i njohu me kapacitet operacionale që përmbush Forca Ajrore, planet për zhvillim afatshkurtër dhe afatgjatë, si dhe nevojat për të ardhmen me qëllim standardizimin e procedurave të operimit dhe realizimit të misionit. Kolonel Metko gjatë takimit të tij vlerësoi edhe ndihmën e dhënë nga ushtria turke për modernizimin e Forcës Ajrore, si në pajisje, po ashtu edhe trajnimin e personelit, si dhe asistencën e vazhdueshme që jep koordinatori turk atashuar në Bazën Ajrore Kuçovë. Më pas me anë të disa brifingjeve mbajtur nga Shtabi i Forcës Ajrore, delegacioni i Forcave Ajrore Turke u njoh me historikun e zhvillimit të Forcës Ajrore Shqiptare, vizionin, misionin, detyrat, objektivat, teknikën ajrore, mbështetjen logjistike dhe mirëmbajtjen, si dhe trajnimi i personelit pilot/teknik. Një tjetër temë ishte edhe misioni, vizioni, gjendja e radarëve si dhe trajnimi i kontrollorëve dhe operatorëve të Qendrës së Kontroll Raportimit, ku një pjesë kanë përfunduar trajnimin në Turqi dhe një pjesë janë në proces. Delegacioni turk zhvilloi vizitë në Bazën Ajrore Kuçovë dhe në Bazën Ajrore Farkë ku u pritën në takim nga komandantët e këtyre bazave. Gjatë këtyre vizitave delegacioni turk u njoh me misionin, detyrat, vizionin, strukturën, objektivat dhe planet e zhvillimit të këtyre bazave, teknikën ajrore, mirëmbajtjen e saj, infrastrukturën, si dhe nevojat për trajnim personeli dhe mirëmbajtje të teknikës ajrore. Gjatë ditëve të zhvillimit të vizitës në repartet e Forcës Ajrore, delegacioni turk diskutoi mbi nevojat që ka Forca Ajrore Shqiptare për trajnim si dhe mbështetjen logjistike apo mirëmbajtjen e teknikës ajrore, për të cilat mund të ofrojnë ndihmën dhe asistencën e tyre. Në përfundim të vizitës në Forcën Ajrore kolonel Hakan Dinç shprehu konsideratë e tij dhe të delegacionit që ai kryeson për standardet dhe kapacitetet operacionale të cilat përmbush Forca Ajrore Shqiptare, si dhe shprehu vullnetin se me bashkëpunimin e frytshëm që ka ekzistuar dhe ekziston midis dy vendeve asistenca dhe ndihma turke do të jetë gjithmonë prezente sa herë që ajo do të kërkohet.

Synohet përmirësimi i kapaciteteve të komunikimit për Forcën Ajrore

Më datë 19 maj 2014, zhvilluan një inspektim të ambienteve të Qendrës së Kontroll Raportimit së Forcës Ajrore, zoti Robert Wojtas, përfaqësuesi i agjencisë NCIA dhe zoti Panagiotis Vergogiannis, menaxher projekti dhe përfaqësuesi i kompanisë "Space Hellas", kompani e kontraktuar nga angjesia NCIA. Ky inspektim u iniciua në kuadër të realizimit të projektit për përmirësimin i kapaciteteve të komunikimit për komandim kontrollin e sistemit NATINAMDS. Të dy përfaqësuesit prezantuan fillimisht në sallën e mbledhjeve të Komandës së Forcës Ajrore arsyetimin e realizimit të këtij projekti dhe shpjegimin teknik të tij. Këto prezantime u ndoqën nga shefi i Shtabit të Forcës Ajrore nënkolonel Kuto Hasani, shefi i Degës së Operacioneve & Stërvitjes nënkolonel Arben Cenolli, specialistë

nga Dega e Zbulimit, Dega e Ndërlidhjes, si dhe specialistë komunikimi nga Qendra e Vëzhgimit Ajror. Pas zhvillimit të dy prezantimeve, të dy përfaqësuesit vijuan me inspektimin e ambienteve Qendrës së Kontroll Raportimit. Gjatë gjithë kohës së inspektimit u shoqëruan nga kapiten Olgert Koroveshi zëvendëskomandant i Qendrës së Vëzhgimit Ajror, toger Bardhul Vreka specialist LAN/WAN dhe Infosec, si dhe nëntoger Donald Shkëmbi specialist sistemesh, të cilët janë deklaruar nga Komanda e Forcës Ajrore si pika kontakti për këtë projekt. Gjatë inspektimit të ambienteve të mësipërme përfaqësuesit e projektit u njohën me kapacitetet që përmbushin këto ambiente në interes të realizimit të projektit.

"Zhvillohet inspektim për realizimin e projektit "Implementimi i përmirësimeve të kapaciteteve të komunikimit në sistemin NATINAMDS"

Nevoja për kapacitete ISR në Shqipëri



MAJOR SAIMIR MUSTAFAJ*

Nuk do të përpiqem që të sjell një përkthim në gjuhën shqipe të termit "Intelligence Surveillance and Recconnaisance" (ISR) pasi një gjë e tillë do te sillte me shumë pështjellim sesa qartësi në pikëpamjen gjuhësore dhe do të kërkoja mirëkuptimin e lexuesit që në vijimësi do të përdor vetëm shkurtimin e termit origjinal në gjuhën angleze, pra, ISR. Në këtë kontekst nuk mund të lë pa theksuar domosdoshmërinë e ndërmarrjes së një iniciative nga institucionet ushtarake përgjegjëse për të standardizuar dhe përditësuar terminologjinë tonë ushtarake me atë perëndimore duke shmangur barbarizmat gjuhësorë.



Prezantim i shkurtër i ISR

Funksionet ISR janë elemente parësore të kapaciteteve mbrojtëse të një vendi dhe ato mund të përfshijnë një mori sistemesh kërkimi dhe përpunimi të informacionit që u nevojitet vendim-marrësve të sigurisë kombëtare dhe komandantëve. ISR është përdorur nga ajri që në kohën e Revolucionit Francez ku balonat u kthyen ne mjete nga të cilat vëzhgohej kundërshtari dhe veprimet e tij. Gjithashtu gjatë Luftës së I-rë Botërore u shënua një kthesë e jashtëzakonshme në konceptimin e kapaciteteve ISR dhe përdorimin e tyre për zbulim strategjik. Në këtë kohë platformat fluturuese (avionët dhe balonat) nuk kishin rreze të gjatë veprimi dhe nuk ishin të pajisura më mjete moderne vëzhgimi, dhe ato përdoreshin për zbulim të frontit dhe për vëzhgim artilerie, vetëm në nivel taktik . Gjithsesi komunikimi mbetej një problem konstant pasi që pilotët duhet të ktheheshin, të ulnin avionin dhe më pas t'u komunikonin konsumatorëve informacionin që kishin vëzhguar gjatë fluturimit. Një gjë e tillë bënte që informacioni të mos vinte në kohë gjë që shpeshherë çonte në marrje vendimesh e veprimesh të pasakta. Shumë shpejt në valën e kësaj Lufte u përmirësuan parametrat e vetë avionëve që përdoreshin për ISR duke u dyfishuar atyre shpejtësinë, trefishuar lartësinë e fluturimit, pesëfishuar fuqinë motorike si dhe u pajisën me armatim. Një përmirësim i tillë bëri që ISR të penetrojë thellë në prapavijat e armikut dhe të shikojë veprimet e tij duke u dhënë mundësinë pilotëve që të vlerësojnë kursin e veprimit të armikut dhe ta raportonë atë në kohë tek forcat kryesore. Në betejën e parë të Marinës (Shtator 1914) avionët ISR zbuluan gabimin fatal të gjeneralit gjerman von Kluck, i cili drejtoi forcat e tij nga lindja me synim që të ndante Parisin nga pjesa kryesore e Forcave Franceze. Me këtë lëvizje, gjen. von Kluck ekspozoi gjithë krahun e djathtë të forcave Gjermane. Një gjë e tillë u zbulua nga kapacitetet ISR dhe u raportua menjëherë tek forcat aleate (ushtrisë franceze dhe forcave angleze) duke u mundësuar atyre që ti sulmojnë e ndjekin gjermanët më shumë se 60 km deri në Lumin Aisne ku ata fortifikuan pozicionet e tyre duke çuar në atë që më vonë u njoh si "Lufta famëkeqe e Transheve". Shembulli i mësipërm ilustron dhe shënon qartazi pikënisjen e formësimit të grumbullimit të informacionit strategjik nga kapacitetet ISR. Bazuar në avantazhet e sjella prej tij, ISR ka marrë një rëndësi të veçantë ndër vite duke evoluar nga 'balonat e Revolucionit Francez' tek satelitët hapësinorë të ditëve të sotme…

ISR në vendet e Aleancës

Gama e sistemeve moderne ISR varion nga pajisje të vogla që operohen në mënyrë manuale e deri tek satelitët orbitor. Disa prej këtyre sistemeve grumbullojnë informacione bazë në funksion të një fokusi të gjerë produktesh analitike ndërkohë që të tjera sisteme janë dizajnuar për të kërkuar të dhëna mbi sisteme specifike armësh. Vende të ndryshme praktikojnë organigrama të ndryshme në lidhje me sistemet ISR. Gjithsesi, nisur nga përdoruesit, zakonisht sistemet ISR i gjejmë të ndara në dy kategori:

a) sisteme kombëtare kryesisht të destinuara për të grumbulluar informacion në interes të Agjencive kombëtare të Inteligjencës, dhe

b) sisteme taktike të destinuara për të mbështetur komandantët në fushëbetejë.

Mënyra më tradicionale e përdorimit të të dhënave të marra nga sistemet ISR është që ato t'u kalohen analistëve për përpunim të mëtejshëm duke nxjerrë një produkt përfundimtar i cili përmbush kërkesën e konsumatorit.

Kur flasim për kapacitete ISR të instaluara në platforma fluturuese, nuk është e re për lexuesin kur themi se ushtritë e vendeve të mëdha përveç se në Forcat e tyre Ajrore kanë kapacitete ajrore (helikopterë dhe avionë me krahë fiks) edhe në përbërje të llojeve të tjera të Forcave si psh në përbërje të Forcave Tokësore; në përbërje të Forcave Detare; në përbërje të Forcave Speciale etj. Këto kapacitete ato i ngrenë, mirëmbajnë e komandojnë në interes të misionit dhe detyrave të tyre. Një ndër këto shërbime është edhe ISR. Në fushën e Zbulimit, ISR është një element tepër i rëndësishëm i cili në varësi të llojit të sensorëve dhe pajisjeve të instaluara në mjetin fluturues ofron video në kohe reale, fotografi me rezolucion të lartë, imazhe nga kamerat termale, përgjim sinjalesh elektronike etj… Në rast se këto nevoja dhe të tjera nuk mund të plotësohen nga mjetet organike, atëherë kërkohet mbështetja e Forcave Ajrore…

> *Funksionet ISR janë elemente parësore të kapaciteteve mbrojtëse të një vendi dhe ato mund të përfshijnë një mori sistemesh kërkimi dhe përpunimi të informacionit që u nevojitet vendim-marrësve të sigurisë kombëtare dhe komandantëve. ISR është përdorur nga ajri që në kohën e Revolucionit Francez ku balonat u kthyen ne mjete nga të cilat vëzhgohej kundërshtari dhe veprimet e tij.*

Po ashtu si ushtritë e këtyre vendeve, edhe agjencitë e ndryshme zotërojnë kapacitete ISR të cilat i përdorin për përmbushjen e misionit të tyre.

Gjendja aktuale dhe nevoja për kapacitete ISR në Shqipëri

Reformimi i herëpashershëm i FA të RSH i ka sjellë ato në një status të tillë që tani nuk kanë më një krah ajror avionësh me krahë të fiksuar por vetëm një sasi helikopterësh të tipave të ndryshme. Kryefjala e ristrukturimit e reformimit të Forcës Ajrore përgjatë më se dy dekadave të fundit ka qenë: "territori I RSH ka një sipërfaqe të vogël dhe përdorimi i avionëve luftarak nuk mund të realizohet në nivelin e duhur të efikasitetit…", gjithsesi, të gjithë e dimë se argumenti dhe arsyeja e vërtetë e këtij reformimi është e lidhur me koston… Si rrjedhim, në inventarin e FA tona, ne nuk kemi avionë me krahë të fiksuar të cilët mund të përdoren si platformë ku të instalohen sensorët e nevojshëm për të krijuar një sistem ISR. Pasja dhe zhvillimi kapaciteteve ISR në ditët e sotme nuk është një luks por një domosdoshmëri për çdo shtet. Një gjë e tillë diktohet nga zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së shkëmbimit të informacionit, rreziqeve asimetrike, lëvizjeve demografike, fleksibilitetit të qarkullimit, kriminalitetit, trafiqeve etj.

Në vendin tonë janë një mori institucionesh të cilat kanë nevojë të herëpashershme për këtë shërbim dhe për produktet e ofruara prej tij. Më poshtë po bëj një listim të shkurtër të konsumatorëve të mundshëm të këtij

> *Gama e sistemeve moderne ISR varion nga pajisje të vogla që operohen në mënyrë manuale e deri tek satelitët orbitor. Disa prej këtyre sistemeve grumbullojnë informacione bazë në funksion të një fokusi të gjerë produktesh analitike ndërkohë që të tjera sisteme janë dizajnuar për të kërkuar të dhëna mbi sisteme specifike armësh. Vende të ndryshme praktikojnë organigrama të ndryshme në lidhje me sistemet ISR.*



informacioni:

- Ministria e Mbrojtjes me Forcat e Armatosura (FARSH) dhe Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes (AIM), është konsumatori kryesor i të gjitha llojeve të mundshme të informacionit të grumbulluar nga sensorët e platformave ISR në mënyrë që të mbështesë operacionet brenda dhe jashtë territorit të RSH. Të gjithë jemi dëshmitarë të përfshirjes së FARSH në koalicione ndërkombëtare duke kryer operacione në rajone të ndryshme të Globit. I gjithë spektri i këtyre operacioneve ka kërkuar dhe do të vijojnë të kërkojë mbështetje me zbulim. Konflikti i dekadës së fundit në Afganistan ka treguar se forma më e kërkuar e mbështetjes me zbulim nga forcat në terren është ISR. Në këtë kontekst, varësisht nga lloji i platformës ISR që Shqipëria do të zotëronte në të ardhmen, si dhe nga rajoni ku mund të kërkohet kryerja e operacioneve të ardhshme, dislokimi i një platforme do të ishte me një përfitim tepër të madh për sigurinë e jetës së forcave tona në terren si dhe do të rriste shkallën e efikasitetit të operacioneve. Një përdorim të gjerë ISR do të gjente në mbështetje të operacioneve që kryejnë FARSH brenda territorit të RSH kryesisht në kuadër të emergjencave civile apo edhe në mbështetje të operacioneve të Forcave Speciale si Kërkim-Shpëtim apo operacione të tjera specifike.

- Ministria e Punëve të Brendshme është konsumatori i dytë kryesor për shfrytëzimin e produkteve të grumbulluara nga asetet ISR brenda territorit të RSH. Ky dikaster është në mënyrë konstante në luftë me krimin e organizuar, terrorizmin, dhe llojet e ndryshme të trafiqeve të paligjshme, por njëkohësisht ofron edhe një sërë shërbimesh të tjera komplekse përfshirë monitorimin e vijës kufitare dhe pikave të kalimit, qarkullimin rrugor, sigurimi objekteve, sigurimin e personaliteteve etj… Për realizimin e këtyre misioneve jetike për sigurinë brenda territorit të vendit përdoren një seri metodash për grumbullimin e informacionit dhe mbështetjen më zbulim të operacioneve në terren. Krahas rrugëve operative për sigurimin e këtyre informacioneve do të ishte tejet efikase përdorimi i kapaciteteve ISR për grumbullimin e informacionit para, gjatë dhe pas kryerjes së operacioneve. Siç është bërë publike në mediat e vendit, është vërejtur se MPB më tepër se një herë është detyruar të kërkojë ndihmën e shteteve të tjera për të sjellë kapacitete ISR për skanimin e territorit të RSH për gjetjen e zonave të kultivimit të lëndëve narkotike dhe kjo për shkak të mungesës së aseteve të tilla jo vetëm në organikën e këtij dikasteri por edhe në atë kombëtare. Asetet ISR do të gjenin një përdorim jashtëzakonisht të gjerë në të gjithë gamën e shërbimeve që ofron MPB me institucionet e saj të vartësisë. Shfrytëzimi i produkteve të ISR do të rriste në mënyrë drastike shkallën e suksesit në të gjitha fazat e operacioneve të ndërmarra për zbulimin dhe goditjen e krimit dhe trafiqeve.

- Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) është një tjetër konsumator i fuqishëm i produkteve ISR. Si njëri prej mekanizmave kryesorë të shtetit për sigurinë kombëtare, ky shërbim do të përdorte me efikasitet informacionet e grumbulluara nga të gjitha llojet e sensorëve të vendosur në platformat ISR qoftë për të amplifikuar kapacitetet e veta informative apo për të mbështetur më zbulim operacionet e mundshme të kryera prej tij. Lartësia e fluturimit të platformave ISR por edhe koha e mënyra e përdorimit të tyre ofron fshehtësinë e nevojshme duke përjashtuar çdo lloj mundësie për kompromet.im.

- Institucione ndërdikasteriale si Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) mund të përdorin produktet e ISR për monitorimin e hapësirës detare dhe zbulimin e rrugëve të mundshme të trafikut të paligjshëm duke zbuluar e mbuluar me vëzhgim pikat e vdekura. Njëkohësisht në raste fatkeqësish dhe për operacione Kërkim Shpëtimi në hapësirën detare, përdorimi i këtij aseti do të ishte tepër efikas. Fatkeqësisht ne jemi dëshmitarë të shumë tragjedive të ndodhura ndër vite në ujërat e bregdetit tonë të cilat kanë përfunduar me viktima. Asetet ISR mund të përdoren me efikasitet edhe si një vegël në procesin e masave për parandalimin e tragjedive të ngjashme.

Kapacitetet ISR mund të përdoren brenda vendit edhe nga një mori institucionesh të tjera të cilat ndër vite kanë artikuluar domosdoshmërinë e aksesit në të dhëna fotografike të detajuara dhe të përditësuara të territorit të RSH. Secili prej institucioneve/konsumatorëve të lartpërmendur, në kohë të ndryshme dhe mënyrë të pavarur mundohet të kënaqë kërkesat e veta duke i dhënë zgjidhje të përkohshme problemit. Po…, është e thjeshtë ta zgjidhësh problemin në mënyrë të përkohshme dhe për secilën nga nevojat e mësipërme apo edhe të tjera të pa listuara, të kërkohet asistenca e huaj siç edhe ka ndodhur më parë për zbulimin e lëndëve narkotike etj…; Por, mos të harrojmë se një gjë e tillë shoqërohet me kosto, si dhe duke marrë parasysh aftësitë eksploruese që zotëron ISR, nuk do të ishte aspak ide e mirë që një shtet të varë shpresat tek një shtet tjetër sado mik që të jetë ai, duke kërkuar asistencën e tij për mbështetje me këto kapacitete dhe aq më tepër për operacione brenda territorit të vet. Arsyet janë të shumta dhe të qarta.

> *Në fushën e Zbulimit, ISR është një element tepër i rëndësishëm i cili në varësi të llojit të sensorëve dhe pajisjeve të instaluara në mjetin fluturues ofron video në kohe reale, fotografi me rezolucion të lartë, imazhe nga kamerat termale, përgjim sinjalesh elektronike etj... Në rast se këto nevoja dhe të tjera nuk mund të plotësohen nga mjetet organike, atëherë kërkohet mbështetja e Forcave Ajrore...*

Zgjidhja

Planëzuesit e mirë ushtarakë u paraqesin vendim-marrësve plane sa më efikase për realizimin e mbrojtjes me sa më pak shpenzime, por, më mirë se kushdo tjetër këta planëzues e kanë të qartë se në fushën e mbrojtjes "boshti i ordinatave" ka një "limit" zbritje i cili po qe se kalohet do të ishte 'fatale' për realizimin e misionit. Rrjedhimisht, është detyrë e po këtyre planëzuesve që me kurajën e vendosmërinë e duhur në çdo rast t'u paraqesin vendim-marrësve argumentet e nevojshme se përse nuk duhet kaluar ky "limit". Në rastin e vendit tonë është tepër e kushtueshme që secili prej institucioneve të mbrojtjes, forcimit të ligjit, shërbimeve të inteligjencës dhe institucioneve/konsumatorëve të tjerë të ketë platformat e veta taktike ISR. Gjithsesi një pjesë e tyre mund dhe duhet të zotërojë me çdo kusht sensorë ISR të cilët përdoren në platforma të vogla fluturuese pa pilot. Nga ana tjetër është krejt e mundshme dhe e logjikshme që të gjitha këto institucione bashkë të kenë një kapacitet të përqendruar ISR me sensorët e IMINT, SIGINT, Radarë, kapacitete C2 dhe pajisje të tjera shtesë të vendosur në platforma/avionë me krahë të fiksuar me dhe pa pilot i cili u ofron shërbimin e kërkuar secilit prej këtyre konsumatorëve.

Ngritja dhe mirëmbajtja

Në një skenar të tillë Forca Ajrore do të ngrinte dhe mirëmbante këtë kapacitet duke shtuar në inventarin e saj dy çifte avionësh me krahë të fiksuar me dhe pa pilot, të cilët do të përdoreshin si platforma për instalimin e sensorëve ISR. Në bazë të procedurave standarde të hartuara për këtë qëllim, FA do t'u ofronte shërbimin e kërkuar të gjithë konsumatorëve kombëtarë sipas prioriteteve të diktuara nga situata. Qendra e analizimit dhe përpunimit të informacionit të mbledhur nga ISR mund të jetë e përqendruar tek AIM e cila do të bënte shpërndarjen e produktit përfundimtar apo transmetimin në kohë reale të të dhënave të papërpunuara tek konsumatorët. Për më tepër secili prej konsumatorëve mund të ketë akses të drejtpërdrejtë në informacionin e grumbulluar sipas kërkesës së tij dhe në mënyrë të njëanshme ta përpunojë e përdorë atë sipas nevojave të veta. Ngritja dhe funksionimi i një kapaciteti të centralizuar ISR për rastin e Shqipërisë do të ishte sa risi në këtë fushë po aq edhe zgjidhje vizionare, e natyrshme dhe e suksesshme qoftë edhe në raportin e kostos me efektivitetin/cilësinë/kohën e marrjes së shërbimit. Në pamje të parë ideja e zotërimit të një numri të vogël avionësh me krahë fiks shkakton një "shok financiar" në disa mendje por në fakt po ta shikosh me syrin e 'comprehensive approach' dhe 'smart defence' (në rang kombëtar) dhe kjo e vendosur në plan afatmesëm dhe afatgjatë do të rezultonte se kostoja e ngritjes dhe mbajtjes është më e ulët sesa shpenzimet (e marra së bashku) që konsumatorët bëjnë për marrjen e këtij shërbimi. Për më tepër sot në tregun botëror ka kompani të cilat ofrojnë një larmi të pafund mundësish, kualiteti dhe çmimesh në ngritjen e kapaciteteve ISR. Kompani të tilla si Northtop GRUMMAN ofrojnë instalimin e të gjithë gamës së dëshiruar të sensorëve në avionë të vegjël me krahë të fiksuar kundrejt kostove të përballueshme. Për ta mbyllur këtë artikull, do të inkurajoja të gjithë palët e interesuara në shërbimin e ofruar nga asetet ISR por edhe në fusha të tjera, që të mos reshtin mendimin, veprimin dhe përpjekjet në krijimin e mundësive për realizimin e misioneve të vetmbështetura në të ardhmen. Sukses i mjaftueshëm do të ishte përfshirja e ideve në planet e modernizimit.

***Oficer Zbulimi në J2**
NATO Special Operations
Headquarters (NSHQ)

Xhihadistët evropianë, vazhdimi i një trendi

MIMOZA GOLIKJA

Kërcënimi i kthimit në Evropë të militantëve me përvojë nga luftimet në Afrikën e Veriut dhe Lindjen e Mesme ka nxitur debate në lidhje me emigracionin dhe integrimin në Evropë dhe ka forcuar ndjenja ksenofobe dhe nacionaliste. Nuk është një fenomen i ri për evropianët të udhëtojnë jashtë vendit për të luftuar. Raporte kanë qarkulluar prej muajsh rreth numrit në rritje të të huajve që luftojnë përkrah islamikëve në vende si Libia dhe Siria. Një nga raportimet ka qenë edhe ai i gazetës spanjolle "El Mundo" kur raportoi më 5 gusht 2013, nga shërbime të papërcaktuara, se burime të inteligjencës evropiane paralajmëronin se organizatat terroriste në Siri mund të ishin duke përgatitur sulme ndërkombëtare, veçanërisht në Evropë. E ndërsa del një informacion i ri nga inteligjenca pavarësisht nëse kërcënimet janë të vërteta ose jo, autoritetet evropiane intensifikojnë luftën kundër terrorizmit dhe kontrollet e emigracionit me qëllim për të penguar sulme të mundshme. Por duke pasur parasysh popullsinë e madhe dhe në rritje të myslimanëve në Evropë dhe lehtësinë e udhëtimit në të gjithë kontinentin, parandalimi i të gjitha sulmeve nuk është dhe shumë i lehtë. Artikulli i "El Mundo" identifikoi grupin rebel sirian Jaish al-Muhajireen uel Ensarwt,(Jaish al-Muhajireen wal Ansar),(ushtria e emigrantëve dhe ndihmësit), e njohur dikur si Brigada Muhajireen, si një grup ku bashkohen shumë të huaj. I krijuar në verën e vitit 2012 nga luftëtarët e huaj dhe i udhëhequr nga çeçenet, grupi kishte rekrutuar pjesëmarrës të huaj nga e gjithë bota dhe u bashkua në muajin shkurt, me dy fraksione të tjera rebele siriane, brigadën Hattabi dhe ushtrinë Muhamedi, (Khattab Brigade and the Army Muhammad). Sipas agjencisë së lajmeve çeçene Kavkaz Center, grupi përbëhej nga rreth 1000 luftëtarë dhe mes të tjerave kishte udhëhequr sulmet në krahinat siriane të Aleppo-s, Latakia-s dhe Idlib-it.

Po kush është origjina kombëtare e tyre?

Në prill të vitit 2013, koordinatori i Antiterrorizmit të BE, Gilles de Kerchove, vlerësonte se rreth 500 qytetarë evropianë po luftonin në Siri, shumica e tyre nga Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Irlanda. Një anketë nga Qendra Ndërkombëtare për Studimin e radikalizmit në King 's College Londër zbuloi se deri në 600 evropianë nga 14 vende, duke përfshirë edhe Austrinë, Spanjën, Suedinë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Gjermaninë, kishin marrë pjesë në konfliktin sirian që kur ai nisi në fillim të vitit 2011, duke përfaqësuar afërsisht 7% deri në 11% të numrit të përgjithshëm të luftëtarëve të huaj në Siri. Studimi tregonte se kontingjenti më i madh i militantëve të huaj, nga 28 deri në 134, kishte ardhur nga Mbretëria e Bashkuar. Mirëpo numri i luftëtarëve të huaj mund të jetë më i lartë duke marrë parasysh se shumë prej tyre qarkullojnë përgjatë arenës së luftimeve dhe kthehen në shtëpitë e tyre në një kohë shumë të shkurtër. Edhe pse askush nuk e di numrin e saktë të të huajve që kanë luftuar në grupet militante xhihadiste, herë pas here dalin në sipërfaqe raporte në lidhje me të huajt e vrarë që veprojnë, midis vendeve të tjera, në Siri, Somali, Libi dhe Jemen. Për shembull në mars të një viti më parë, 2013, ishte një person që mbante emrin e luftës si Abu Kamal As - Swedee dhe një person tjetër danez i njohur si Abdul Malik al-Danimarki, që të dy anëtarë të Jaish al-Muhajireen wal Ansar dhe që u raportuan të vrarë në shpërthimet vetëvrasëse në Siri. Instituti i Uashingtonit për Politikat e Lindjes së Afërt dhe Partnerët Globalë të Flashpointit, drejtuan një studim të përbashkët gjatë vitit 2013 që vëzhgonte faqet e ekstremistëve të internetit dhe analizonte origjinën kombëtare të 280 luftëtarëve të huaj të raportuar të vdekur duke luftuar përkrah rebelëve në Siri nga korriku 2012 deri në maj 2013. Studimi gjeti se 60 prej të vrarëve vinin nga Libia, 47 nga Tunizia dhe 44 nga Arabia Saudite. Numri i të vdekurve përfshinte gjithashtu edhe luftëtarë të vetëm nga vende të tilla si Danimarka, Franca, Uzbekistani, Irlanda, Maroku, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

Xhihadistët kthehen në shtëpinë e tyre

Komunitetet myslimane kanë ekzistuar në Evropë për shekuj me radhë, por marrëveshjet për ardhjen e punëtorëve dhe politikat e emigracionit të qetë në vitin 1960 sollën valët e emigrantëve myslimanë nga Turqia në Gjermani, nga Algjeria në Francë dhe nga Pakistani në Mbretërinë e Bashkuar. Kufizimet e udhëtimit ndërkufitar në BE janë minimale, dhe disa autoritete evropiane përpiqen "të mos e vështirësojnë e të mos shqetësojnë bashkësitë myslimane me shpresë se mosveprimi do të mbrojë Evropën nga sulmet e islamikëve të radikalizuar". Mirëpo ajo që i shtohet problemit është se luftëtarët e kthyer xhihadistë nuk kapen zakonisht nga kontrollet standarde të emigracionit. Madje nuk ka qenë e vështirë për islamikët evropiane për të marrë mbështetje, dalluar kryesisht nga njerëzit dhe grupet në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Këto lidhje pastaj mund të jenë përdorur për tu përpjekur për të kryer sulme terroriste brenda Evropës. Po sjellim disa prej sulmeve të fundit dhe tentativa që përfshijnë xhihadistët evropiane. Në mars të vitit 2013, forcat e policisë federale belge në luftën kundër terrorizmit ndaluan një makine krimi që çoi në një shkëmbim zjarri dhe në vdekjen e Hakim Benladghem, një qytetar francez me prejardhje algjeriane. Nga ana tjetër Benladghem ishte i njohur për trajnimin e marrë si një ushtar parashutist në Legjionin e Huaj Francez. Policia zbuloi një sasi armësh dhe eksplozivësh në banesën e tij dhe besoi se Benladghem kishte qëllim të kryente një sulm të armatosur në Evropë. Në gusht 2012, policia spanjolle dhe franceze shkatëruan një komplot të Al Kaedës nga dy çeçenë, Eldar Magomedov dhe Mohamed Ankari Adamov, si dhe një turku me emrin Cengiz Yalcin. U dyshua se plani i tyre ishte të lëshonin pajisje plasëse të improvizuara afër objektivave britanike dhe amerikane në Spanjë, Francë etj në Evropë gjatë Olimpiadës në Londër. Për të tre të dyshuarit u tha se ishin pjesëtarë operativë të al Kaedës të cilët kishin marrë trajnim në Pakistan. Në korrik 2012, po kështu një shtetas suedez me origjinë libaneze, Ebu Abdurraham, kishte komplotuar për të hedhur në erë një avion pasagjerësh të SHBA gjatë Olimpiadës në Londër. Abdurraham besohet të jetë konvertuar në islam në vitin 2008 dhe ishte rekrutuar për operacionin në një kampi stërvitor terrorist në Jemen. Në mars 2012, një franko-algjerian i quajtur Mohammed Merah qëlloi dhe vrau një rabin dhe tre fëmijë jashtë një shkolle hebraike në Tuluzë, në Francë. Një javë para sulmit, Merah shenjestroi një grup të parashutistëve francezë, duke vrarë katër prej tyre. Ai thuhet se kishte në shënjestër personelin e ushtrisë për shkak të përfshirjes së tij në grupe të panjohura militante në luftën e Afganistanit.

Në France dhe në Britaninë e madhe kërcënimi i shkaktuar nga islamistët radikalë shkaktoi një problem të rëndësishëm publik, duke i bërë të dyja shtetet hezituese në furnizimin me armë të rebelëve sirianë për shkak të lëvizjeve të tyre të mëparshme për t'i dhënë fund një embargoje gjatë mbështetjeve të tilla. Të dy vendet gjithashtu janë të vetëdijshëm se rrethimet e mëdha myslimane të përhapura në të gjithë kontinentin sigurojnë strehë tërheqëse për xhihadistët evropianë, të cilët kanë marrë trajnime në vende të tilla si Pakistani, Siria, Afganistani, Jemeni dhe Afrika e Veriut. Këto komuna sigurojnë mjedise efektive për radikalizmin për shkak të izolimit të tyre relativ dhe detyrimeve kulturore dhe fetare që ata zotërojnë për të mos i dhënë të drejtën e votimit popullsisë emigrante. Që nga koha e destabilitetit në Afrikën e Veriut dhe luftimeve të zgjatur në Siri, është përhapur frika e sulmeve nga vendasit që kthehen në Evropë pas luftimeve jashtë vendit të tyre. Kjo shkaktoi shqetësim jo vetëm për Francën dhe Mbretërinë e Bashkuar, të cilët kanë popullsi të madhe myslimane dhe tashmë kanë përjetuar sulme terroriste, por edhe për vende të tilla si Danimarka dhe Suedia, e cila është parë shpesh si një shembull pozitiv lidhur me pranimin e emigrantëve.

Politikat e emigracionit, perspektiva e xhihadistve të Evropës

Me kontrollet kufitare brenda Bashkimit Evropian të shfuqizuara në masë, islamistët radikalë mund të kërcënojnë lehtë vendet e shumta, duke bashkëpunuar midis tyre. Në fillim të gushtit, nëntë vendet e BE-së, si Franca, Belgjika, Holanda, Luksemburgu, Gjermania, Polonia, Italia, Mbretëria e Bashkuar dhe Suedia, i bënë thirrje Parlamentit të BE-së për të mbështetur krijimin e një baze të dhënash evropiane të pasagjerëve të cilët hyjnë dhe dalin nga Bashkimi Evropian. Ndërsa shumica e vendeve të BE-së tashmë mbledhin të dhëna të tilla, nga ana tjetër këto të dhëna nuk përhapen, sepse Parlamenti Evropian është i shqetësuar rreth cenimit të të drejtave të privatësisë. Në mënyrë që të adresohen më mirë kërcënimin e sulmeve xhihadiste, forcohet siguria përgjatë kufijve të bllokut të BE, gjë që ndikon mbi evidentimin e terroristëve të mundshëm. Njoftimet e kohëve të fundit tregojnë për lëvizjet e hyrjet dhe daljet e luftëtarëve në Siri. Vendet e Evropës perëndimore japin ndihmën në formën monetare, personelit dhe hardware me qëllim evidentim të rasteve nëse xhihadistët evropiane kthehen nga fusha e betejës për të kryer sulme në Evropë. Mirëpo kjo edhe mund të çojë në më shumë kritika të Komuniteteve Myslimane Evropiane për mungesën e integrimit të tyre. Por papunësia në rritje, e kombinuar me kërcënimin e xhihadistëve që kthehen, rrit presionin mbi qeveritë evropiane për të shtrënguar politikën e emigracionit.

Pavarësisht numrit të madh të myslimanëve evropianë të cilët kanë marrë trajnim përtej detit dhe kanë luftuar në vende të tilla si Somalia, Libia dhe Siria, pak prej tyre në fakt kanë kryer sulme pas kthimit në Evropë. Megjithatë, në një kohë kur ideologët xhihadiste kërkojnë xhihad individual në perëndim, këta individë të trajnuar përbëjnë një kërcënim shumë real. Problemi është se mënyra me të cilën luftëtarët janë rekrutuar nga Evropa apo vende të tjera është i ndryshëm nga njëri vend në tjetrin dhe është vështirë të gjenden. Si pasojë, është e vështirë për të përcaktuar se kush mund të kryejë një sulm terrorist, çfarë lloj sulmi mund të jetë dhe ku ai mund të ndodhë. Ky problem përfshin edhe strategjinë bazë të propaganduar nga al Kaeda dhe vështirësitë e prishjes së trajnimit terrorist që ndodh jashtë vendit. Problemet specifike në Evropë përfshijnë praninë historike myslimane në kontinentin dhe lehtësinë relative ndërkufitare të udhëtimit evropian. Autoritetet vazhdimisht do të sfidohen në përpjekjet e tyre për të penguar sulmet terroriste, jo vetëm në Evropë, por si kudo ku ka objektiva të prekshme.

Libri duhet të jetë në bibliotekë...

BERNARD ZOTAJ
DREJTOR I QLMI-SË

Libri ka rol të veçantë, të lartë e konstruktiv në edukimin, përsosjen e individit e të shoqërisë, por dhe të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura. Libri është trashëgimi e përjetshme, e vlefshme dhe ndriçuese gjatë jetës së njeriut. Rëndësia e kulturës së të shkruarit në historinë e njerëzimit është ndër elementet kryesore në studimin e historisë të kulturës të popullit shqiptar por dhe të popujve të tjerë. Për rëndësinë e rolit të librit dhe për përsosjen e shoqërisë e dëshmojnë dhe Forcat e Armatosura nëpërmjet librave të publikuara. Nëpërmjet librave komandantë, gjeneralë, strategë ushtarakë kanë arritur të bëhen të përjetshme dhe njerëz të mëdhenj në historinë botërore e shqiptare. Po me anë të librave ata kanë arritur të ndikojnë në shoqëri, si dhe në FA. Të gjitha kulturat fillojnë me libra, pjekurinë e arrijnë me to dhe me anë të librave i transferojnë eksperiencat e tyre për gjeneratat e ardhshme. Në këtë mes, edhe kultura e librit ushtarak ka një karakteristik të veçantë, për shkak se që nga lashtësia i është kushtuar një interes dhe rëndësi e veçantë dijes dhe arsimit të luftëtarëve. Studimi është konsideruar si rruga më e rëndësishme për të arritur në shkencë dhe dije. Libri është mjet transmetues i mesazhit, kulturës dhe civilizimit brez pas brezi. Libri është mjet i mendimit dhe plotësues i njeriut. Me anë të këtij mjeti mund të matet fuqia dhe potenciali i njeriut nga aspekti shkencor dhe dijetar. Në epokën e sotme masmedias i janë shtuar mjete të ndryshme komunikimi dhe ndërlidhjeje, por libri nuk e ka humbur vlerën e tij dhe nuk është vjetërsuar kurrë. Libri është një trashëgimi e përhershme dhe fenomen tepër i vlefshëm në jetën e njeriut. Në shkollat tona ushtarake gjithmonë është theksuar roli i veçantë në rëndësinë e përdorimit të librit, për të shkruarit dhe lexuarit, sepse librit luan një rol të pamohueshëm në formimin dhe plotësimin personal të njeriut dhe shoqërisë. Libri është memoria e njeriut. Dija, trashëgimia dhe historia mijëra vjeçare e njerëzimit mund të gjenden vetëm në libra dhe aktualisht asnjë mjet tjetër nuk mund të zëvendësojë librin në fushën e mendimit dhe intelektit. Në këtë mënyrë injektimi i frymës dashamirëse për librin dhe leximin është një nga detyrat kryesore të intelektualëve dhe funksionarëve në fushën e kulturës dhe dijes në FA. Natyrshëm për librin mendja të shkon tek shtëpitë e botimit, tek shkrimtarët, tek përkthyesit dhe tek të gjithë intelektualët ushtarakë dhe atyre civilë që përpiqen në fushën e librit dhe të leximit. Por nga njohja në lidhje me librin dhe bibliotekën në repare dhe njësi të FA, del se për librin e kujdesin ndaj tij duhet të bëjmë më shumë veprimtari kulturore, si dhe organizim të ditëve e të javëve të punës me librin. Ditë e javë të librit në njësi e reparte organizohen me raste. Ende nuk ka programe kulturore e shkencore për të tërhequr të pasionuari me librin. Ceremonitë dhe organizimi i tyre për dhurata të lexuesit dhe botuesit më të mirë të librit, për personat që kanë bërë më shumë përpjekje në zgjerimin e kulturës së leximit të librit, si dhe për institucione dhe botuese të librave të cilat kanë luajtur një rol të veçantë në zgjerimin e kulturës së librit, janë të pakta. Ndër ceremoni mund të përmendim zhvillimin e konkursit të organizuar nga Qendra e Kulturës, Medias dhe

Botimeve të Mbrojtjes, por ende në shkolla ushtarake dhe njësi e reparte nuk organizohen panaire të librit, ngritje dhe sistemim të bibliotekave, si dhe zhvillim të simpoziumeve të ndryshme për të shqyrtuar pozitën e librit në FA. Po kështu mund të zhvillohen edhe konkurse të ndryshme të cilat kanë lidhje me librin dhe mënyrën e zgjerimit të kulturës së tij. Ende vënia në punë e bibliotekave të cilat kanë libra në sasi të ndryshme dhe të konsiderueshme nuk është në lartësinë e duhur. Mesatarja e leximit dhe e frekuentimit në këto biblioteka ndryshon nga njëra njësi në tjetrën. Megjithatë statistikat tregojnë se kjo mesatare është akoma e vogël dhe duhet shumë punë për të bërë për të arritur një nivel të pranueshëm dhe të pëlqyeshëm. Duke qenë se po flasim për librit, e shohim të arsyeshme të ofrojmë disa rrugë për të përfituar sa më shumë nga leximi i librit dhe dijet e tij. Këto këshilla nuk kanë lidhje me asnjë kulturë, gjini apo punë. Studimi dhe leximi është një veprim i pranueshëm dhe i vlerësueshëm. Në kohën e leximit dhe studimit të librit qoftë ai mësimor apo kulturor, është e rëndësishme ti kushtohet një qëllimi të caktuar dhe të ketë kohë të programuar. Shpejtësia e veprimit, dhe pranimi i metodave dhe teknikave të reja, janë shumë të rëndësishme në studimin dhe leximin e librit. Një metodë që kemi zgjedhur në programin e sotëm është metoda e quajtur studimi aktiv. Në metodën e studimit aktiv përdoret marrja e shënimeve dhe kategorizimi i tyre në bazë të kohës dhe temës. Kjo metodë ndihmon në mësim dhe përqëndrim. Një çështje tjetër është koha. Duhet të zgjedhim kohën e studimit dhe të leximit të librit, kur jemi të kthjellët dhe të çiltër me qëllim që përqendrimi të jetë sa më i lartë. Për të ruajtur përqëndrimin duhet të zgjidhet një ambient i qetë. Specialistët janë të mendimit se zgjedhja e një vendi të caktuar për të studiuar dhe lexuar, shton efikasitetin gjatë leximit. Përveç kësaj, kushtet fizike të këtij ambienti gjithashtu duhet të jenë të përshtatshme si nga aspekti i temperaturës, dritës dhe zërave. Studimi i mirë, kuptimi dhe perceptimi i temave të shkrimtarit padyshim që ngre lart kualitetin e studimit. Dhe ky studim mund e duhet të bëhet në bibliotekat e FA. Përveç kësaj, leximi dhe studimi konsistojnë në mësimin dhe kuptimin e temave. Një nga mënyrat efikase në studimin aktiv është teknika, e cila është e përbërë nga pyetje, lexim, mendime dhe praktika. Në këtë metodë në fillim i hedhim një vështrim të përgjithshëm në të gjithë librin në mënyrë që të krijojmë një ide të përgjithshme për temën e parashtruar. Më pas mbi temat e parashtruara formojmë pyetje me qëllim që para leximit të librit të arrijmë në përfundimin se mund të gjendet përgjigje apo jo për këto pyetje. Në hapin e dytë të gjitha temat e parashtruara në libër përmblidhen dhe bashkëngjiten me dijet paraprake të lexuesit në mënyrë që të formohet një kuptim i plotë dhe i saktë. Në këtë metodë studimi, këshillohet të rilexohen informacionet e mbledhura nga libri dhe të shprehen në gjuhën e vetë lexuesit. Me përsëritjen e përmbajtjes së librit lexuesi kupton se cila pjesë për të është e kuptueshme dhe cila jo. Dhe së fundi mund të analizojë vetën e tij dhe të kuptojë se ç'pjesë të librit ka kuptuar dhe mësuar. Në disa raste është e nevojshme të formohen pyetje mbi çështjen e parashtruar në libër dhe përgjigjet duhet të kërkohen në përmbajtjen e librit. Për të përfituar nga kjo metodë, në rast se libri i përket vetë lexuesit, ai mund të nënvizojë disa pjesë të librit ose të marrë shënime nga ai. Në këto shënime mund të shtohen edhe pikasjet e tij. Në këtë mënyrë formohet një këndvështrim efikas për leximet e ardhshme të lexuesit. Në epokën e tanishme të një shpërthimi të vërtetë të mjeteve moderne, si ato kompjuterike, audiovizuale etj., libri ende mbetet instrumenti më i përhapur dhe padyshim më efektiv në edukim. Nëse për nga forma - libri praktikisht nuk ka ndryshuar, roli dhe vendi i tij në procesin e mësimit dhe të leximit ka pësuar një ndryshim të ndjeshëm. Tradicionalisht libri është përdorur kryesisht për transmetimin e njohurive. Ai gjithashtu ka plotësuar funksionin implicit të shpërndarjes së vlerave sociale, morale e kulturore, Në ditët e sotme këto funksione mbeten themelore. Por librat duhet t'u përgjigjen kërkesave të reja: të zhvillojnë tek lexuesi shprehitë e veprimtarisë së pavarur, të propozojmë metoda të ndryshme të të mësuarit, të integrojnë dijet e fituara në praktikën e përditshme dhe një listë mund të plotësohet edhe me kërkesa të tjera të reja që shtron çdo ditë koha në të cilën jetojmë dhe punojmë.

Përvojë e bukur e risi e re për librin

Qendra e Librit dhe Mbështetja me Informacion, në zbatim të misionit të saj, më datë 19 maj 2014, në bashkëpunim me Komandën e FD, zhvilloi një veprimtari për të rritur frymën e bashkëpunimit, për të njohur, pasqyruar e transmentuar vlerat e FA-së në punën me librin dhe bibliotekat në epokën dixhitale. Në veprimtari morën pjesë drejtues të Forcës Detare, ushtarakë, si dhe punonjës civil, e cila u zhvillua në ambientet e komandës, në sallën e bibliotekës. Drejtori i QLMI-së theksoi rëndësinë që ka kjo qendër, arritjet e deritanishme, problematika, propozime, si dhe vizionin për të ardhmen. Në vijim u theksua gjendja e librit në FA, inventari elektronik i tij, perspektivat e dixhitalizimit, vendi dhe roli që duhet të lozin sistemimi i bibliotekave në çdo forcë dhe repart, si dhe blerja e librit të ri. Specialisti Dedë Kola theksoi rolin që ka puna me librin e ri. Për të pranishmit u ndoq dhe dokumentari historike: "Nga Tetova gjer në Vlorë", që bën fjalë për ministrin e parë të Mbrojtjes, Mehmet Pashë Dërralla. Të pranishmit dhanë mendime si dhe plotësuan një pyetësor të përgatitur për mbarëvajtjen e punës me librin dhe bibliotekat në FA. Kapiten i Rangut të III-të Diodor Muja, e quajti ardhjen e QLMI-së, një përvojë e bukur dhe risi në FD. Ai diskutoi mbi problemin e mosfurnizimit me libër të ri, duke ngritur çështjen e vendosjes së një përgjegjësi të mirëfilltë për librin në bibliotekë. Kapter Kastriot Hysi në diskutimin e tij, përmendi krijimin e një arkivi të librit në elektronikë, sidomos të librit të vjetër, të detarisë, të cilat do ti shërbenin punës krijuese në këtë Forcë. Shefe e Sektorit të bibliotekave Elisabeta Koka, në fund të takimit, i dhuroi punonjëses së bibliotekës së FD-së Valbona Medani, disa libra, si dhuratë nga stafi i QLMI-së. Librat dhe revistat kanë të bëjnë me historinë ushtarake të popullit shqiptar. Më tej u vizitua biblioteka e repartit që ishte e thjeshtë dhe modeste, si dhe u pa nga afër punë që bëhet për ngritjen e muzeut të repartit. Kapiten e Rangut të I-rë Ferdinand Kreshpani, zëvendëskomandant i FD pati një tamim me përfaqësuesit e qendrës, ku u theksua roli që duhet t'i kushtojmë librit dhe biblioteksë së repartit. Stafi u takua dhe me shefin e Shtabit të FD-së, Kapiten i Rangut të II-të, Adnojnd Agastranga.

Përparësi librit për Bazën e Pashalimanit

Më datë 21 maj 2014, në Bazën Detare të Pashalimanit nga stafi i QLMI-së u theksuar vendi dhe roli që duhet të luaj kjo strukturë për librin dhe bibliotekat në FA. U theksuarëndësia e kësaj qendre, mbi mundësitë për të ngritur sistemin e integruar të planifikimit, botimit dhe blerjes së librit. librat që janë botuar për të nga ish kuadro të saj. Për njohjen e librave të botuar për bazën e Pashalimanit foli specilaistja Adriana Zotaj e cila theksoi përvojën shekullore të kësaj baze në historinë kombëtare, si dhe për Antologjinë e Detarisë Shqiptare të studiuesit Shefqet Kërcelli. Rëndësi ju kushtuan dhe librave të kuadrove si petrit Myftyu, Myfyt Qorduka, Fatos Voshtima dhe Dr. Kudret Çela e Dr. Çapajev File. Përgjegjësi i librit në qendrë Pano Hallko, gazetar, theksoi rëndësinë që ka leximi dhe studimi i librit nga ushtarakët e FA. Probleme në punën me librin ngritën dhe kuadrot Qerim Shkrepaj, Fatmir Lutaj dhe Spartak Shyti etj. Ndërsa Kapiten i Rangut të I-rë, Sybi Zenelaj bëri një prezantim të punës që bëhet në repart në lidhje me librin dhe me bibliotekën e repartit. Në takim ishte e pranishme dhe shefja e BCU-së e FD, Kapitene e Rangut të II-të, Ferzilete Sulaj e cila ishte e pranishme në të gjithë veprimtarinë e zhvilluar në Forcat Detare.

"Mësimet e Nxjerra" nga misionet "EAGLE 1-7"

Procedurat ligjore për sigurimin e jetës për FS, prioritet në çdo kohë

Analizë mbi rishikimin e procedurave ligjore për sigurimin e jetës, për kohën e dorëzimit të detyrës ndërmjet kontingjenteve, për shpërblimin në rastet kur personeli i misionit humb jetën ose plagoset gjatë misionit dhe për rehabilitimin psikologjik

KOLONEL DRITAN DEMIRAJ*

Gjatë kryerjes së misionit nga kontingjentet "Eagle" të BFS në Afganistan, u konstatua se personelit që kryen detyra luftarake u bëhet sigurim jete për një periudhë kohore vetëm për 6 muaj. Por misioni mund të zgjasë 6-7 muaj, kohë kjo që nevojitet për dorëzimin dhe marrjen e detyrave ndërmjet kontingjenteve dorëzuese dhe marrëse (periudha 1-2 javore e familjarizimit), në rastet kur nuk sigurohet mjeti ajror për transportin strategjik, për arsye sigurie, kohe, rrethanash të ndryshme dhe pikërisht për këtë periudhë kohore, personelit nuk i bëhet sigurimi i jetës, gjë e cila sipas gjykimit tim duhet të korrigjohet dhe të jenë të siguruar të gjithë personat të cilët janë të dislokuar në çdo moment. Për këtë qëllim lindi si domosdoshmëri sigurimi i jetës të personelit edhe për kohën që qëndrojnë gjatë dorëzimit të detyrës (periudha 1-2 javore e familjarizimit) ndërmjet kontingjenteve. Asnjë nga operatorët të cilët marrin pjesë në luftim nuk janë të kënaqur nga sasia e parave që përfiton një operator, i cili humb jetën në misione të tilla. (Kjo gjë u vërejt në kohën kur Kapiten Feti Vogli ra në krye të detyrës dhe asnjë person qoftë familjar por dhe operator nga BFS, nuk ishte i kënaqur nga ai shpërblim, përkundrazi shumë të pamotivuar). Për këtë qëllim gjykoj që duhet të bëhen sa më parë rishikime ligjore për sigurimin e jetës dhe për shpërblimin në rastet kur ndonjë pjesëtar i efektivit në mision humb jetën ose plagoset. Duhet marrë si shembull sigurimi i jetës së personelit të dërguar në mision nga shtetet e tjera të NATO-s, që në gjykimin tim, duhet të jetë të paktën edhe 100% më i lartë se ai aktual, krahasuar me atë që është në fuqi tani nga MM. Domosdoshmëria e ngritjes së strukturave për rehabilitimin psikologjik të pjesëmarrësve në misione para dhe pas kthimit, përkujdesja sociale ndaj familjeve të tyre gjatë kohës së kryerjes së misionit. Në Direktivën e Mbrojtjes të nxjerrë nga MM në vitin 2011 theksohet: Rehabilitimi Psikologjik, veçanërisht i ushtarakëve në mision luftimi, përkujdesja sociale ndaj familjeve të tyre, duhet të përbëjnë një projekt të diferencuar të skemës së përkujdesjes sociale. Brenda muajit mars të vitit 2011 është punuar projekti për ngritjen dhe funksionimin e një qendre rehabilitimi dhe këshillimi psiko-social për ushtarakët në misione. Misionet jashtë vendit, nisur nga shtrirja në kohë, shumëllojshmëria e stërvitjeve dhe e detyrave që kryhen para dhe gjatë misionit, ndikojnë ndjeshëm në gjendjen psikologjike të personelit, qoftë të vetë personit pjesëmarrës, por veçanërisht tek familjarët që ky person lë pas. Ndaj është e domosdoshme që krahas përgatitjes profesionale që padyshim ndikon ndjeshëm në realizimin me sukses të detyrave në mision, po aq e domosdoshme është përgatitja psikologjike e këtij personeli para nisjes për mision, gjatë kryerjes, por edhe pas përfundimit të këtij misioni. Nga ana tjetër, do të ishte më e arsyeshme që edhe familjarët e ushtarakëve në mision të angazhoheshin në një grup (ose këshill familjar) për të mundësuar në krijimin e një sistemi komunikimi ndërmjet familjarëve të ushtarakëve, zinxhirit të komandimit, autoriteteve dhe institucioneve vendore. Qëllimi kryesor do të ishte inkurajimi dhe mbështetja nëpërmjet familjarëve të ushtarakëve, duke mundësuar shkëmbimin e informacionit dhe mbështetjen reciproke.

Për sa më sipër, nisur dhe nga procedurat që ndjekin vendet e NATO-s, anëtarë të së cilës jemi dhe ne, sugjerojmë përgatitjen dhe hartimin e një formulari (e cila tashmë është bërë), i cili duhet të plotësohet nga ushtaraku para se të niset në mision. Ky formular mund të përmbajë këshilla dhe detyrime të strukturave të FA për përkujdesjen familjare të ushtarakëve pjesëmarrës në misione, të tilla si:

- Plotësimi i formularit nga vetë ushtaraku, firmosja prej tij dhe nga komandanti, për çdo rubrikë që mund të ketë formulari.
- Informacion mbi gjendjen familjare, personat në ngarkim, mosha, statusi dhe aftësitë fizike të tyre.
- Informacion mbi mundësitë e përkujdesjes së familjareve të tij kur ai ndodhet në mision, në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera administrative në fuqi.
- Përfitimet ekonomike, financiare dhe të drejtat për familjarët e tij, kur është në mision.
- Ky akt mund të firmoset edhe nga familjari kryesor dhe kryetari i grupit të familjarëve.

Gjykoj që jo vetëm kaq, por duhet të ngrihet një qendër e specializuar rehabilitimi me psikologë me eksperiencë në drejtim, të cilët do të duhet që të fillojnë të krijojnë programe të cilat ndihmojnë në rehabilitimin e personelit i cili kthehet nga misionet luftarake me probleme psikologjike. Raste të tilla të kthimit të personelit tashmë kanë filluar të shfaqen dhe aktualisht në FA në dijeninë time nuk ka njerëz të specializuar në këtë fushë.

Praktikat kundër mjeteve shpërthyese të improvizuara (KMSHI)

Krahas të gjithë TTP të strukturave terroriste, talebanëve dhe armëve që ata përdorin kundër trupave tona në operacionet në Afganistan, sipas të gjitha statistikave dëmet më të mëdha në njerëz dhe teknikë vijnë nga përdorimi i KMSHI-ve. Informacioni në këtë pjesë të kapitullit freskon, ndan dhe përditëson informacione për njësitë dhe ushtarakët tanë që do të marrin pjesë në misionin e ISAF-it, mbi TTP-të kundër mjeteve shpërthyese të improvizuara (KMSHI), praktikat më të mira nga Operacioni Enduring Freedom (OEF) që po vazhdon në Afganistan, operacion në të cilin edhe Forcat tona Speciale po japin kontributet e tyre të jashtëzakonshme. Ky informacion mund të përdoret përveç këtij disertacioni dhe gjatë trajnimeve para dislokimit nga qendrat e stërvitjes luftarake, trajnuesit e qendrave të stërvitjes dhe në linjat e trajnimit për kundër mjeteve shpërthyese të improvizuara KMSHI. Informacionet nga teatri i Afganistanit vërtetojnë se operacionet e suksesshme COIN në bashkëpunim me popullsinë afgane janë thelbësore për luftën KMSHI. Forcat e koalicionit, në përbërje të të cilit veprojnë dhe kontingjentet tona, duhet të sigurojnë ndihmë nga popullsia lokale për tu lajmëruar nga ata (në këtë drejtim rrjeti i informacionit që u ngrit në zonën e operacionit nga kontingjenti "Eagle-1" ishte një shembull që për shumë kohë përmendej nga eprorët e ushtrisë amerikane) për të gjetur mjetet shpërthyese të improvizuara (MSHI) dhe të sulmojnë rrjetet e rebelëve në prodhimin dhe ndërtimin e MSHI-ve.

Taktikat, teknikat dhe procedurat (TTP) e armikut

TTP e armikut përfshijnë:

- Rritja e avantazhit të pengesave natyrore dhe të ndërtuara nga njeriu. Terreni është shumë kufizues në disa zona të Afganistanit. Kanalet vaditëse, kanalet e tjera dhe hendeqet janë të shumta, ndaj operacionet në këmbë janë të nevojshme për shkak të mundësive të kufizuara për përdorimin e automjeteve. Forcat talebane dhe kundërshtare, përdorin terrenin ndërmjet tyre dhe forcave të koalicionit. Ata lëvizin vazhdimisht lart e poshtë duke përdorur terrenin për mburojë dhe fshehje. Forcat armike përdorin terrenin e kanalizuar për të rritur efektin e MSHI, duke drejtuar forcat koalicionit në zona vdekjeprurëse.
- Vlerësimi dhe synimi i forcave tona. Rebelët mund të dallojnë njësitë e forcave tona, forcën, synimet dhe dallimet midis këmbësorisë, marinsave, apo FS. Forcat rebele mund të lejojnë këto lloj njësish të kalojnë e të presin për objektiva më të dobëta siç janë kolonat e furnizimit dhe pastaj të planifikojnë goditjen e tyre.
- Ripërdorimi i zonave të pritave/MSHI dhe sulmet e koordinuara me prita dhe armë. Rebelët përdorin zonat e suksesshme të mëparshme për sulmet MSHI dhe pritat. Po të studiosh me kujdes vëndet që kanë sjellë humbjen më të madhe të forcave dhe mjeteve të koalicionit në Afganistan, janë vendet në të cilat janë sulmuar më shumë ushtria sovjetike, gjatë konfliktit të gjatë të viteve 1979-1989 në Afganistan. Këto zona nuk kërkojnë zbulim të madh dhe kanë pika vrojtimi të mira, rrugë largimi dhe pengesa ndërmjet zonës së mjeteve të shpërthimit dhe pikës së inicimit (shpërthimit). Pengesat në zonë gjithashtu mund të lehtësojnë largimin e tyre. Rebelët zakonisht e shoqërojnë një sulm me mjete shpërthimi me zjarrin e armëve të lehta ose granatahedhësve (RPG) brenda distancave nga 50-300 metrave, duke krijuar një pritë më komplekse. Një mjet shpërthimi kur aktivizohet, zakonisht inicion fillimin e hapjes së zjarrit në pritë. Rebelët luftojnë jo me kohë të madhe dhe gjatë konfuzionit fillestar të sulmit mundësojnë dëme të konsiderueshme, megjithëse përpiqen të ruajnë superioritet lokal. Ata shkëpusin kontaktin nëpërmjet rrugëve të largimit të planifikuara që më parë, në këmbë (shtigje të fshehta, shtretërve të lumenjve, kanaleve vaditës ose kanaleve). Shumica e sulmeve të rebelëve kanë patur një plan ikjeje të shpejtë. Ka patur relativisht pak sulme me kontakt të gjatë.

***Shef i Qendrës së Simulimit**

"Dita Ndërkombëtare e Muzeve", në axhendën e muzeut të FA

37 vjet më parë, në vitin 1977, me Rezolutën Nr.12 të Këshillit Ndërkombëtar të Muzeve (ICOM) është caktuar 18 Maji, si "Dita Ndërkombëtare e Muzeve". Gjatë kësaj periudhe, Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve, që varet nga UNESCO, ka ndihmuar në ngritjen e nivelit shkencor të muzeve përmes botimeve të ndryshme, veçanërisht në përcaktimin e kritereve dhe standardeve për trajtimin e objekteve të trashëgimisë kulturore. Më shumë se 30.000 muze në rreth 100 vende të botës, përfshirë edhe vendin tonë, angazhohen me aktivitete të larmishme me rastin e kësaj dite. Edhe për Muzeun e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Dita Ndërkombëtare e Muzeve ka qenë një ditë e shënuar me një aktivitet origjinal gjithëpërfshirës. Në këtë kuadër u përgatit dhe u realizua "Dita e Hapur" me objektivin e qartë për të promovuar vlerat historike të Forcave të Armatosura jo vetëm tek ushtarakët, por në mbarë shoqërinë e interesuar për këtë qëllim. E rëndësishme është që personeli i Muzeut të FA-së i përfshirë në këtë aktivitet punoi me përkushtim për ta pasuruar këtë muze, e reflektuar kjo në ngritjen dhe funksionimin e

seksionit të misioneve paqeruajtëse të forcave speciale në kuadrin e angazhimit të tyre në përbërje të aleatëve, ngritjen dhe funksionimin e seksionit të elementëve të veçantë të kulturës në FA-së në vite, si dhe përgatitjen e një ekspozite për kolonelin Holandez "Tomson", rënë në vendin tonë në kuadrin e misionit ushtarak holandez në ndihmë të Qeverisë së Vlorës. Muzeologët e këtij muzeu patën një shtrirje të gjerë bashkëpunimi, sidomos me komandën e FT-së (batalionin special), QKSHMMb, si dhe me Shoqatën Shqiptaro-Holandeze në pasurimin e elementëve të ekspozuara rishtas. Bazë e këtyre treguesve ka qenë dhe eksperienca e institucioneve homologe brenda dhe jashtë vendit, e cila ka qenë nxitëse e pasurimit të këtyre elementëve. Me shumë vlerë është që të kuptojmë se njohja e së kaluarës së FA-së, ka rëndësi vendimtare në përcaktimin e së ardhmes mbi bazën e identitetit të vet. Muzeu i Forcave të Armatosura synon të nxisë mirëkuptimin dhe vlerësimin e historisë së Ushtrisë Shqiptare tek publiku kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të inkurajojë dialogun me dhe midis qytetarëve e ushtarakëve, mbi të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen Forcave të Armatosura. Ai përfton, ruan dhe studion, provat materiale dhe jo materiale të trashëgimisë historike dhe kulturore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilat i komunikon dhe i paraqet në një mjedis, që nxit edukimin dhe argëtimin. Objektet që mbahen në muze prezantojnë jo vetëm ngjarje historike por interpretojnë historinë ushtarake përmes objekteve të trashëgimisë kulturore. Ja pse opinionet dhe vlerësimet e rreth 500 vizitorëve në Ditën e Hapur, përfshirë këtu nxënës shkollash, ushtarakë aktivë e në rezervë, veteran, qytetarë nga Tirana, drejtues të njësive e institucioneve ushtarake të FA-së, përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, të shoqatave të ndryshme jo qeveritare etj, shprehin qartë interesimin për vlerat historike dhe kulturore të ekspozuara jot ë mbyllura në vetvete, port e shtrira në të gjitha qelizat e jetës dhe aktiviteteve historike me karakter ushtarak të FA-së në vite. Kjo ditë ishte një promovim i një pjese të kësaj historie, e cila në të ardhmen do të pasurohet më tej me misionin e vetëm për vënien në dispozicion për grupet e interesuara të vlerave edukative të trashëgimisë ushtarake të Forcave të Armatosura.

Fëmijët e ushtarakëve, vizitë në Muzeun Kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"

Në kuadër të ditës ndërkombëtare të muzeve, Drejtoria e Aktiviteteve dhe Marrëdhënieve me Komunitetin në Qendrën e Kulturës, Medias e Botimeve të Mbrojtjes, zhvilluan më 18 maj një vizitë në qytetin e Krujës dhe pikërisht në Muzeun Kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", i njohur edhe si Muzeu i Skënderbeut dhe Muzeu i Krujës. Në këtë aktivitet morën pjesë fëmijët ushtarakëve, të cilët janë pjesë e kurseve që organizon sektori i rekreacionit si dhe familjarët e tyre. Drejtori i muzeu ishte njoftuar për këtë vizitë dhe u tregua i gatshëm për të ofruar e servirur të gjithë informacionin e nevojshëm. Për artistët e vegjël, të frymëzuar nga historia dhe objektet e trashëgimisë kulturore, u zhvillua një konkurs ku u ndanë pesë çmime: 1 çmim i parë, të cilin e dha përgjegjësi i aktiviteteve, z. Gazmend Çaçi, dy çmime të dyta dhe dy të treta. Gjithashtu, u zhvillua një vizitë në objektet rreth muzeut ku dhe u bënë filmime e fotografi. Një vizitë e veçantë u bë dhe në pazarin e vjetër të Krujës, ku çdo vizitor mori diçka si kujtim nga ky qytet-muze. Muzeu Kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" është një nga më të vizituarit në Shqipëri. Përurimi i tij është bërë më 1 nëntor të vitit 1982 në Kështjellën e Krujës, kryeqendra e shtetit të arbrit dhe personifikim i disfatës së ushtrive osmane, për tre herë rresht, në shekullin XV. Njëkohësisht, ky muze ka dhe karakterin e një memoriali që trajtohet si kullë shqiptare e veriut. Arkitektë të këtij muzeu janë Pirro Vaso dhe Pranvera Hoxha. Kompleksi i muzeut është shpërndarë në disa hapësira të cilat vizitohen kronologjikisht sipas ngjarjeve. Në këtë muze janë të ekspozuar mjaft objekte, dokumente dhe bibliografi origjinale, riprodhime autentike që flasin qartë për historinë e popullit shqiptar në shekullin XV e më gjerë. Në këtë muze numërohen pavijone të tilla si pavijoni i antikitetit dhe mesjetës së hershme, pavijoni i principatave shqiptare, i pushtimit osman dhe përballimit të këtij pushtimi, pavijoni i kështjellave mesjetare, i qëndresës shqiptare, kancelaria e Skënderbeut, biblioteka, salla e princave, e pinakotekës dhe së fundi

pavijoni i trashëgimisë dhe i jehonës. Në këto pavijone janë ekspozuar objekte prej qeramike, bronzi, hekuri, bakri, faksimile të ndryshme, ikona origjinale, shkrime, këmbanë e vitit 1462, shpata origjinale të shekullit XV, etj. Mbarëvajtja dhe siguria e këtij udhëtimi u garantua nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave së Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që vuri në dispozicion autobusin dhe policinë ushtarake dhe për të shkon një falënderim i veçantë.

Dita Ndërkombëtare e Muzeve organizohet çdo vit që prej 18 Majit të vitit 1977. Kjo ditë ofron mundësi për profesionistët e muzeve për t'u takuar me publikun dhe për t'i njoftuar ata për sfidat me të cilat përballen muzetë. Në të vërtetë, pas përcaktimit të muzeve të ofruara nga ICOM, një muze është një organizatë jo-fitimprurëse, institucion i përhershëm në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, të hapura për publikun, e cila fiton, ruan, hulumton, komunikon dhe ekspozon trashëgiminë e prekshme dhe te paprekshme të njerëzimit dhe mjedisit të tij për qëllime të arsimit e studimit. Pra, Dita Ndërkombëtare e Muzeve shërben si një platformë për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi rolin që luajnë muzetë në zhvillimin e shoqërisë sot, në një nivel ndërkombëtar. Këshilli Ndërkombëtar i Muzeut (ICOM) është organizata kryesore e muzeve dhe profesionistëve të muzeve me një fushë globale, e angazhuar për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, në të tashmen dhe në të ardhmen. Angazhimi ICOM për kulturën dhe promovimin e njohurive është i përforcuar nga 31 komisionet e tij ndërkombëtare, të dedikuara për një gamë të gjerë të specialiteteve muzeale, të cilët kryejnë kërkime të avancuara në fushat e tyre përkatëse për të mirën e komunitetit muze. Shqipëria, anëtare e këtyre organizmave, ka së paku dhjetë vjet që i deklaron zyrtare festat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me muzetë dhe monumentet e trashëgiminë shpirtërore e materiale. Dita Ndërkombëtare e Muzeve organizohet çdo vit që prej 18 Majit të vitit 1977. Ajo është shpallur nga Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve-ICOM pranë UNESCO. Kësaj dite çdo vit i kushtohet një temë e caktuar që lidhet me rolin dhe funksionin e muzeve në shoqërinë njerëzore dhe përkujtohet me aktivitete të ndryshme në të gjithë botën. Sipas vendeve këto aktivitete mund të jenë ditore, gjatë një fundjave apo javore. Pjesëmarrja e Shqipërisë në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve synon, që përveç vizitave falas në muze, t'i sjellë muzetë sa më afër njerëzve duke dëshmuar rolin e tyre si porta të dijes, ruajtjes së kujtesës historike dhe vlerave të trashëgimisë kulturore. Nëpërmjet organizimit të një sërë aktivitetesh duhet të kontribuohet më tej në lidhjen e njerëzve me historitë e vendeve të tyre dhe nxitjen e kujdesit të mëtejshëm ndaj aspekteve të trashëgimisë kulturore.

Komanda e Përgjithshme e UNÇSH-së

Dr. Asllan Zemani*
MSC. Alketa Gjoliku

Kundërmësymja e UNÇSH-së në pranverën e vitit 1944 krijoi një gjendje të re, atë shtimit jo vetëm në numër, por edhe të formacione luftarake të përmasave të mëdha të Ushtrisë nacionalçlirimtare. Ndërsa aleatët perëndimor e kishin zgjeruar pjesëmarrjen në shkatërrimin e fuqive hitlerianëve duke mbështetur edhe rritjen e lëvizjeve nacionalçlirimtare në Europë, gjë që njëkohësisht favorizonte rritjen formacioneve vullnetare partizane si dhe organizimet e tyre në "divizione e korparmata dhe organizimin e të gjitha reparteve partizane të qarqeve në brigade" e aq më shumë në shtimin e veprimeve të tyre luftarake. Pikërisht në këtë kohë UNÇSH-ja përfshinte një numër prej afro 35 000 partizanësh të rreshtuar në radhët e formacioneve të rregullta siç ishin 9 brigada sulmuese si dhe në sërë formacionesh të niveleve nga më të ndryshme por edhe ato me veprimtari rajonale, pra çeta e batalione vullnetare territorial. Ndërkohë Ushtria nacionalçlirimtare e drejtuar nga Shtabi i Përgjithshëm, i kishte dhënë një varg goditjesh te fuqishme, "veçanërisht thyerje e mësymjes armike gjatë dimrit të viteve '43-'44 si dhe kundërmësymja e saj pranverore i kishte shkaktuar humbje dhe dëme të ndjeshme njerëzore dhe materiale armikut. Pas këtyre goditjeve dhe humbjeve armiku i tronditur ishte strukur në qendrat dhe qytetet kryesore të vendit duke u mbrojtur në to me masa të forta sigurimi e për rrjedhojë ai kishte humbur nismën operative, të cilën e kishte fituar Ushtria NÇ. Gjysma e sipërfaqes së vendit ishte çliruar. Duke i shfrytëzuar këto favore udhëheqja e Luftës NÇ dhe Këshilli i Përgjithshëm NÇ mblodhën në Përmet Kongresin i Antifashist NÇ që u mbajt nga 24-28 maj të këtij viti. Në të krahas, vendimeve të sferës politike e sidomos të pushtetit të ardhshëm, u gjykua të vendosej "kalimi në mënyrë të përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit". Për të realizuar këtë synim ishte e domosdoshme të krijoheshin "forcat dhe formacionet e mëdha", që do ta vinin në jetë atë. Prandaj një nga vendimet me karakter ushtarak qe "krijimi i një ushtrie plotësisht të rregullt" por edhe domosdoshmëria e "dhënies së gradave". Kjo ide ishte hedhur në të vërtetë qysh më parë dhe Kongresi i Përmetit vetëm sa e konfirmoi dhe e konkretizoi atë. Vetëm një ushtri e tillë do të ishte në gjendje t'u përgjigjej kërkesave dhe detyrave që i duhej të zgjidhte tani për LANÇ-in, siç ishte objektivi themelor strategjik i saj - dëbimi i pushtuesve të huaj dhe çlirimi i plote i vendit. Riorganizimi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe shndërrimi i saj në ushtri të rregullt bënin të mundur të kryheshin operacione të mëdha të shkallës operativo-strategjike. Nga shtabet e njësive të mëdha partizane që ishin krijuar e që do të krijoheshin (divizione të reja e korparmata), në bazë të urdhrave të Komandës së Përgjithshme, do të planëzoheshin goditje të fuqishme kundër armiqve për çlirimin e territoreve të gjera, të qyteteve kryesore dhe të mbarë vendit. Në shtabet dhe në përbërjen e reparteve e të njësive si dhe të reparteve të llojeve të ndryshme të armëve dhe të shërbimeve të UNÇSH u bënë ndryshime sasiore dhe cilësore. Krijimi i Komandës së Përgjithshme të UNÇSH forcoi udhëheqjen dhe drejtimin operativo-strategjik të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe bëri të mundur që konceptet e planet operativo-strategjike të njësive të mëdha të UNÇSH të përpunoheshin e të hartoheshin në përputhje të plotë me urdhrat që lëshonte herë pas here Komanda e Përgjithshme e UNÇSH. Mbi një plan konkret të hartuar, filloi zbatimi i masave të ndryshme ndër më kryesoret ishin: njësimi i Komandës së Përgjithshme në një të vetme; krijimi i njësive të mëdha të kësaj ushtrie, që do të ishin divizionet dhe korparmatat; zhvillimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i armëve dhe i shërbimeve ekzistuese; aftësimi i komandave dhe i shtabeve të njësive e formacioneve të tjera të ushtrisë; sigurimi i rezervave materiale si ushqim, veshmbathje, medikamente mjekësore, dhe armatosja e forcave partizane e deri tek vendosja e gradave në ushtri. Krahas këtyre, po në atë plan parashikohej edhe marrja e një vargu masash të nevojshme me karakter jo-ushtarak, si për organizimin dhe forcimin e partisë, të rinisë dhe të punës së tyre në ushtri. Këto detyra diktonin si domosdoshmëri që edhe udhëheqja strategjike e ushtrisë t'u përgjigjej kërkesave dhe nivelit më të lartë të organizimit ushtarak. Kjo nevojë buronte dhe për faktin se formacionet e Ushtrisë NÇ, në këtë fazë të fundit të luftës do të ndërmerrnin detyra të mëdha të shkallës operativo-strategjike, për çlirimin e plotë të vendit. Kështu aktiviteti i tyre do të shtriheshin dhe do të kryheshin në sipërfaqe territoriale me përmasa të gjera, nga njëra pjesë e vendit tek tjetra, ku do të ndërthureshin midis tyre operacionet mësymëse me ato të zonave të çliruara si dhe përtej kufijve të vendit. Me vendim të Kryesisë së Këshillit Antifashist NÇ, u formua Komanda e Përgjithshme e UNÇSH-së, e cila tani njësohej nëpërmjet emërtimit të një Komandanti të Përgjithshëm të saj. Kjo detyrë e lartë iu caktua E. Hoxhës, i cili deri në këtë kohë kishte kryer detyrën e Komisarit Politik të Shtabit të Përgjithshëm atij iu dha grada gjeneralkolonel. Komanda e Përgjithshme, sipas dokumentacionit të asaj periudhe, ishte organi më i lartë ushtarak dhe politik i ushtrisë NÇ, që bënte drejtimin e gjithë veprimtarisë ushtarake, politike dhe ekonomike të kësaj ushtrie. Me krijimin e saj udhëheqja strategjike e ushtrisë u ngrit në një nivel më të lartë si për organizimin dhe për drejtimin e njësive të shkallës operativo-strategjike. Drejtimi i ketyre njësive, nëpërmjet tyre edhe i formacioneve të tjera, mori një trajtë krejtësisht të rregullt. Tani ai bëhej më i shpejtë dhe më i centralizuar nëpërmjet urdhrave dhe udhëzimeve të Komandës së Përgjithshme. Për rrjedhojë edhe arti i luftës u ngrit më lart, organizimi dhe bashkërendimi i operacioneve ushtarake të shkallës së lartë me pjesëmarrjen e njësive të mëdha të UNÇ-së u përsos, ashtu siç u çua më tej taktika e luftës partizane, por duke zbatuar shpesh me sukses edhe taktikën e luftës ballore. Ndërkohë edhe komandave dhe shtabeve e njësive të mëdha iu la më tepër nismë dhe mëvetësi në planëzimin, organizimin dhe drejtimin e operacioneve të tyre luftarake. Krijimi i Komandës së Përgjithshme si një komandë unike, ndikoi mjaft në realizimin me frytshmëri të lartë të përpjekjeve dhe të masave për të përsosur organizimin e UNÇSH-së, për të përdorur me efektivitet më të lartë llojet e armëve dhe të shërbimeve, të cilat ishin rritur ndjeshëm nga ana sasiore e cilësore. Kjo mundësoi një drejtim të vazhdueshëm e të shëndoshë të formacioneve operativo-strategjike të UNÇSH-së. Pranë Komandës së Përgjithshme të UNÇSH-së mbetej Shtabi i Përgjithshëm Madhor, i cili varej prej saj dhe njëherësh ishte hallkë lidhëse mes kësaj komande dhe shtabeve të njësive të shkallës së madhe, që u krijuan. Ky shtab bënte përpunimin dhe përgatitjen e planeve të operacioneve të UNÇSH-së sipas idesë së Komandës së Përgjithshme, si dhe drejtimin e tyre sipas udhëzimeve që lëshonte po ajo komandë. Gjithashtu ai merrej me hartimin e urdhrave, të udhëzimeve, të qarkoreve dhe të rregulloreve, që kishin si objekt organizimin, furnizimin me veshmbathje, me medikamente mjekësore dhe me armatime e municione, administrimin dhe rregullimin e jetesës së formacioneve partizane e asaj rezervë etj., por sidomos për mënyrat e të luftuarit në llojet e luftimeve dhe në kushtet e veçanta, si dhe për krijimin e përsosjen e llojeve të armëve e të shërbimeve të UNÇSH-së dhe të tjerëve problemeve të Luftës Antifashiste.

Kryetar (shef) i Shtabit të Përgjithshëm u emërua Spiro Moisiu, i cili kishte qenë komandant i tij deri në Kongresin e Përmetit.

Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm (Shtatmadhorisë) të UNÇ-së, pas unifikimit të Komandës së Përgjithshme dhe vendosjen e gradave ushtarake, më 28 Maj 1944, Sipas urdhrit të datës 28 maj 1944 janë: Gjeneralmajor Spiro Moisiu - kryetar i Shtabit Madhor (Shtatmadhorisë), kolonel Myslim Peza - anëtar i këtij shtabi dhe komandant i Grupit të Pezës, kolonel Dali Ndreu - anëtar i këtij shtabi dhe komandant i Divizionit të I Sulmues, kolonel Mehmet Shehu - nënkomandant i Divizionit të I Sulmues dhe anëtar i shtabit, kolonel Hysni Kapo - përfaqësues i PKSH-së pranë shtabit të Zonës Operative Vlorë-Gjirokastër, nënkolonelët: Islam Radovkicka, Ramadan Çitaku, Mustafa Gjinishi, Haxhi Lleshi, Baba Faja Martaneshi dhe komandant i Qarkut të Martaneshit, Bedri Spahiu dhe Komisar i Zonës I Operative. Me vendim të Kryesisë së Këshillit Antifashist NÇ të Shqipërisë të datës 1 nëntor 1944, u bënë në gjirin e këtij shtabi disa ndryshime në gradimet. Dali Ndreu i jepet grada gjeneralmajor, Bedri Spahiu i jepet grada – kolonel. Për mbarëvajtjen e punëve të këtij shtabi, në përbërjen e tij u formuan aparate dhe organizma të shumëllojshme të domosdoshme, të cilët mundësonin që organizimi, planëzimi dhe drejtimi i luftës të fitonin trajtë më të vendosur dhe efektive, në përputhje me detyrat e reja që shtroheshin para UNÇSH-s. Të tillë ishin Komisariati politik, Shtabi operativ, Seksioni i brendshëm, Shërbimi qendror i formacionit, Seksioni Shëndetësor, Drejtoria ekonomike, Grupi i specialisteve etj. E tërë kjo strukturë e re, ishte sa e thjeshtë aq dhe operative. Ajo ishte në gjendje që të përpunonte të gjithë atë masë të dhënash që vinin nga njësitë dhe nga formacionet e tjera të mëvetësuara, si dhe nga burimet e tjera informative, të planëzonte e të drejtonte operacionet në të cilat do të merrnin pjesë, pastaj forcat e UNÇSH-së.

***Historian ushtarak**

Lista e kurseve të ofruara nëpërmjet programit CETPM/IMET", për vitin fiskal 2014.

ANEKS A

Nr.	Periudha	Titulli I Kursit	Kuotat	Kriteret	Pershkrimi I Kursit	Afati
1	26 Shtator 2014 -15 Dhjetor 2014	Programi i Studimeve të Aplikuara të Sigurisë/ Program in Applied Security Studies (PASS)	**1 kuote**	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada →Toger – Major / Civil ekuivalent	Përshkrimi: Programi siguron edukim të nivelit të lartë në çështjet e politikës së sigurisë, të mbrojtjes, marrëdhënieve ndërkombëtare, ligjit ndërkombëtar, luftës kundër krimit, korrupsionit dhe trafikimit njerëzor dhe të drogës.	Jo me vone se 25 Prill 2014
2	16-Korrik-08-Gusht-2014	Aspektet ligjore të mbështetjes me burime të mbrojtjes në rastet e emergjencave civile	**1 kuote**	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → e pa përcaktuar; Të tjera → rekomandohet që personeli i propozuar për ndjekjen e këtij kursi të kryej detyra në shtab, planifikim, këshilltar ligjor ose detyra komanduese	Përshkrimi: Ky kurs tre javor promovon mbështetjen e autoriteteve civile nëpërmjet burimeve të mbrojtjes në përputhje me parimet demokratike të rregullave dhe ligjeve në fuqi, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përdorimi i forcës në mënyrë të arsyeshme. Kursi do të prezantojë mekanizmat ndërkombëtar ligjorë për dhënien e ndihmës humanitare në mënyrën më të mirë të pranueshme dhe në kohën e duhur, për ato vende të cilat janë goditur nga fatkeqësia natyrore. Qëllimi i kursit është të promovojë përdorimin e burimeve të mbrojtjes me përgjegjësi dhe efikasitet, në mbështetje të forcave të policisë dhe autoriteteve të menaxhimit të emergjencave civile, si dhe të rrisë kapacitetet e vendeve partnere për planifikimin dhe marrjen e asistencës së nevojshme në rastet e një fatkeqësie natyrore, nga Shtetet e Bashkuara dhe nga vendet e tjera donatore.	Jo me vone se 22 Maj 2014
3	30-Gusht-12-Shtator-2014	Veprimet Civilo-Ushtarake në luftën kundër terrorizmit	**1 kuote**	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → Major-Kolonel / Civil ekuivalent	Qëllimi i këtij kursi është që të mbështesë këndvështrimin ndërkombëtar të komponentëve politik dhe ushtarak në luftën ndërkombëtare kundër terrorizmit, si dhe të rrisë kapacitetet e partnerëve të koalicionit për zhvillimin e programeve afat-shkurtra dhe afat-gjata për të luftuar terroizmin. Programe të qëndrueshme dhe në përputhje me principet demokratike. Ky kurs ofron një panoramë të plotë të të gjitha formave të terrorizmit me një theks të vecantë në formulimin e strategjisë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	Jo me vone se 22 Maj 2014
4	01-Shtator 21-Nentor-2014	Kursi I shtabeve te bashkuara.	**1 kuote**	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → Major-Kolonel; Të tjera → të kenë përfunduar "Kursin e komandës dhe shtabit të përgjithshëm ose kurse të tjera ekuivalente jashtë vendit; pjesëmarrësit duhet të zotërojnë mirë gjuhën angleze dhe të jenë të jenë të aftë për të mbajtur prezantime mbi misionin, kapacitetet dhe eksperiencën e tyre në Forcat e Armatosura;	Kursi siguron studimin mbi strukturat e bashkuara dhe të ndërthurura, planëzimin dhe operacionet, aspektet që lidhen me sigurinë kombëtare e ndërkombëtare me qëllim përgatitjen e pjesëmarrësve për të shërbyer në komanda të bashkuara. Në veçanti tematika do të përmbajë parimet dhe konceptin themelor të strukturës së komandës së unifikuar të SHBA, organizimin, përbërjen dhe funksionet e një komande të bashkuar, planëzimi në nivel operacional, procesi i vendim marrjes ushtarake etj.	Jo me vone se 22 Maj 2014

Në kuadër të bash-këpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Ministrisë së Mbrojtjes i është ofruar pjesëmarrja në kurse institucionale dhe funksionale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Qendrën Marshall, sipas periudhave të cilësuara në listën bashkëlidhur ANEKS A "Lista e kurseve të ofruara nëpërmjet programit CETPM/IMET", për vitin fiskal 2014. Drejtoria e Arsimimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve ka vijuar praktikën për kërkim kandidaturash nga strukturat e FARSH. Me qëllim që ky njoftim të jetë sa më gjithë përfshirës është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura lista e kurseve dhe dokumenteve që kërkohen për aplikim për këto kurse.

NJOFTIM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
DREJTORIA E ARSIMIMIT DHE PËRKUJDESJES SOCIALE TË USHTARAKËVE

Kërkim kandidaturash për pjesëmarrjen në kursin "Aspektet ligjore të mbështetjes me burime të mbrojtjes në rastet e emergjencave civile", në kuadër të programit CETPM/IMET

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Ministrisë së Mbrojtjes i është ofruar pjesëmarrja në kursin "Aspektet ligjore të mbështetjes me burime të mbrojtjes në rastet e emergjencave civile (Legal Aspects of Defense Support of Civil Authorities)", i cili do të zhvillohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në periudhën 16.07-08 .08.2014.

Kriteret:

Niveli i gjuhës	anglisht 80 pikë;
Grada	e pa përcaktuar;
Të tjera	rekomandohet që personeli i propozuar
për ndjekjen	
	e këtij kursi të kryej
	detyra në shtab, planifikim,
	këshilltar ligjor ose
	detyra komanduese

Përshkrimi: Ky kurs tre javor promovon mbështetjen e autoriteteve civile nëpërmjet burimeve të mbrojtjes në përputhje me parimet demokratike të rregullave dhe ligjeve në fuqi, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përdorimi i forcës në mënyrë të arsyeshme. Kursi do të prezantojë mekanizmat ndërkombëtar ligjorë për dhënien e ndihmës humanitare në mënyrën më të mirë të pranueshme dhe në kohën e duhur, për ato vende të cilat janë goditur nga fatkeqësia natyrore.

Qëllimi i kursit është të promovojë përdorimin e burimeve të mbrojtjes me përgjegjësi dhe efikasitet, në mbështetje të forcave të policisë dhe autoriteteve të menaxhimit të emergjencave civile, si dhe të rrisë kapacitetet e vendeve partnere për planifikimin dhe marrjen e asistencës së nevojshme në rastet e një fatkeqësie natyrore, nga Shtetet e Bashkuara dhe nga vendet e tjera donatore.

Propozimet e kandidatëve të mundshëm të shoqërohen me CV-të përshkrimet e punës dhe formularët me të dhëna personale, në gjuhën angleze jo më vonë se 22.05.2014.

Për informacion dhe paqartësi, lutemi të kontaktoni pikën e kontaktit në DAPSU, Major Tahir Çuka, Tel 510 16 14, e-mail: cukat@mod.gov.al .

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

Drejtori
KUJTIM KADZADEJ

Shqipëria e pastër

Divjaka - Si ishte

Divjaka - Si u bë

Golemi - Si ishte

Golemi - Gjatë aksionit

Shëngjini - Si ishte


Shëngjini - Si u bë

Seman - Gjatë aksionit

Golemi - Si u bë


Rrjoll - Si ishte

Rrjoll - Si u bë

Currila - Gjatë aksionit

Currila - Si u bë